

**QENDRA PER BASHKEPUNIM MIDIS VENDEVE JO ANTARE
DREJTORIA PER ARSIMIN, PUNESIMIN, PUNEN DHE CESHTJET SOCIALE
KOMITETI PER ARSIMIN**

RAPORT TEMATIK MBI POLITIKAT KOMBETARE PER ARSIMIN – KOSOVE

Pakti I Stabilitetit per Europen Juglindore

Tabela 1: Task Force mbi Arsimin

**Perkthyer nga: Adriana Bisha
Perkthimi u mundesua nga SEE ECN.**

PARATHENIE

Ky raport mbi arsimin ne Kosove eshte pergatitur ne kuadrin e Qendres per Bashkepunim me vendet jo antare (CCNM) te OECD si pjese e programit te tij per bashkepunim me Paktin e Stabilitetit per Europen Juglindore. Sekretariati si Koordinator per Politiken e Edukimit te Pergjithshem dhe Ndryshimin e Sistemit te TaskForce, ne Tabelen 1 te Paktit te Stabilitetit ka zhvilluar nje Raport Tematik per Politiken Arsimore te Rajonit me

seksione mbi Shqiperine, Bosnia-Herzegovina, Bulgaria, Croatia, FYROM, Kososva, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe nje Kapitull mbi cesgtjet Rajonale. Temat e trajtuara jane : mesuesit, programet, drejtimi ne shkolle, shkolle arsimi i ulet parashkollore, dhe kujdesi femijve.

Secili seksion paraqet nje pasqyre te pergjithshme te sistemit arsimor, ceshtje dhe pengesa qe dalin ne kryerjen e reformes dhe rekomandime. Rekomandimet jane trajtuar ne menyre te tille qe te jene te dobishme per formuluesit e politikave kombetare, dhe te ndihmojne vendet donatore te Paktit te Stabilitetit, dhe asistencen Rajonale te Insitucioneve. Pervec kesaj raportet mund te sherbejne dhe si baze per analize me te hollesishme te sektoreve te vecante te arsimit.

Tranzicioni i Rajonit drejt nje demokracie pluraliste dhe ekonomi tregu, eshte shenuar nga ndryshime ekonomike sociale dhe politike te nje gjeresie dhe thellesie te jashtezakonshme. Talentet, aftesite dhe njohuria e njerezve jane thelbesore ne kete proces, per kete arsye ndihet nevoja e reformave ambicioze dhe emergjente ne fushen e arsimit qe cuan antaret e Tryezes 1 te Paktit te Stabilitetit te caktojne arsimin si nje nga kater fushat prioritare.

Mbi bazen e materialit baze te pergatitur nga autoritetet ne fushen arsimore te Rajonit, dhe mbi bazen e raporteve dhe informacionit ekzistues, qe eshte paraqitur ne mbledhje gjate regjistrimit ne internet, ky Raport tematik jep nje analize te sistemit arsimor pare ne driten e konteksit social dhe politik te Rajonit dhe te Ceshtjeve prioritare, te njejta, me te njejten cilesi efikasitet dhe trajtim.

Raportet Tematike mbi Politiken Arsimore ne Europen Jug-Lindore u mundesuan nga grante te ofruara nga Austria, Finlanda, Greqia, Zvicer dhe UNICF. Nje ndihme shtese u dha nga Keshilli Britanik, Buroja CROSS, Vendet e Ulta, Fondacioni i Trajnimit Europian (ETF), Zelanda e Re, Fondacioni per Shoqeri te Hapur, Banka Boterore, dhe Qendra per Studime te Politikes Arsimore (CEPS, Universiteti i Ljubljanes).

Antaret e ketij ekipi ishin: Johhana Crighton, (Holande), Raportues i Pergjithshem Steven Bakker (Hollande), Linda Beijsmi (Hollande), Alexandru Crisan (Rumani), Elsie Hunt (Shtetet e Bashkuara). Anthony Gribben (ETF), Gregor Ramsey (Australia), Eluned Roberts-Schweitzer (Banka Boterore), Pasi Sahlberg (Finland), Christine Stromberger, and Ian Whitman (Sekretariat).

Opinionet e shprehura dhe argumentat e perdorura ne kete raport jane pergjegjesia e vete autoreve, dhe nuk reflektojne ne asnje menyre ato te Qeverise se Kosoves, te OECD apo te Qeverive te Vendeve Antare.

Eric Burgeat
Drejtor
Qendra per Kooperim me Jo-Antare

TABELA E PERMBAJTJES

PARATHENIA

KOSOVA

Te dhena te pergjithshme
Hyrje dhe konteksi
Sistemi arsimore
Ceshtje te tjera

Te dhena statistikore
Kuadri ligjor dhe objektivat e politikës
Administrata dhe reforma sistematike
Qeverisja dhe drejtimi
Ceshtje dhe veshtiresi ne qeverisje dhe menaxhim
Barazi ne pranim, arritje dhe suksese
Ceshtje financiare
Curriculum
Shperndarja dhe arritjet
Standartet dhe curriculumi
Curriculumi : Pershtatjet Interim 1999-2000 dhe 2000-2001
Struktura e re e sistemit arsimor
Cilesia e curricules
Metodat e Mesimdhenies dhe Mesimit
Sigurimi I teksteve dhe mjetet mesimdhenese
Reforma e Curricules
Vleresimi dhe Provimet
Ceshtje dhe Veshtiresi ne Curricul, Standarte dhe Vleresim
Personeli Arsimor
Mesuesit
Personeli Mesimor ne Kosove
Rrogat dhe Pagat
Trajnimi I Mesuesve
Ceshtje dhe Veshtiresi ne Personelin Arsimor
Arsimi Parashkollor
Veprimet e Qeverise ne Arsimin Parashkollor
Ceshtje dhe Pengesa ne Arsimin Parashkollor
Arsimi Profesional dhe Trajnimi
Administrata
Kushtet Materiale
Lidhjet midis Shkolles Profesionale,Ekonomise Lokale dhe Strukturave te Tregut Punes
Reformat Aktuale
Ceshtje dhe Veshtiresi ne Arsimin Profesional
Arsimi I Larte
Origjina dhe Zhvillimi
Pershtatja Akademike
Administrata
Financa dhe Buxheti
Studentet: Pranimi, Frekuentimi, Mesimi dhe Vleresimi
Ceshtje dhe Veshtiresi ne Arsimin e Larte
Rekomandime
Rekomandime: Politika dhe Menaxhimi
Rekomandime: Curriculum, Curricula, Standartet dhe Vleresimi
Rekomandime: Mesuesit
Rekomandime: Arsimi Parashkollor
Rekomandime: Arsimi Profesional
Rekomandime: Arsimi I Larte

KOSOVA

Te dhena Te Pergjithshme

- Siperfaqja:** 10.887 km², (1/3 e madhesisë së Belgjikës)
- Numri i Banoreve:** 2,1 milion (sipas llogaritjeve të vitit 1998). Rritja e popullsisë është rreth 20 mijë në vit, sipërfaqja mesatare të shtëpive e vlerësuar për 6-7 persona. Popullsia është më e reja në Europë, me moshe mesatare dhe afërsisht 50% nën moshën 20 vjeç. Numri i lindjeve më i larti në Europë (23,1 për 1000), por gjithashtu dhe vdekshmëria më e lartë në femijë (27.8 në 1000 lindje të gjalla).
- Dendësia e Popullsisë:** 193 për Km², pjesa më e populluar e ish-vendeve Jugosllave/ shpërndarja urbane,rurale(para-lufte): 30% urbane , 70% rurale.
- Perberja Etnike:** Statistika e koheve të fundit (1991),llogaritë 2 numrin e përgjithshëm të popullatës 1.975 milion, 82,2% Shqiptarë të Kosovës,9.9% Serbë të Kosovës, 1% Malazetë, 2.9% Muslimanë, 2.2% Romë,0,5% Turq, 0,4% Kroatë,dhe 0.7% të tjerë. Para 1998 dhe para konflikteve të 1999,popullsia totale vlerësohej midis 1.8 dhe 2,1 milion,nga të cilët rreth 90% popullsi Shqiptarë,7% Serb, dhe 3% i mbetur,ishin Malazetë, Boshnjak,Turq dhe Romë(sepse gjatë konfliktit të fundit u kthyen në refugjatë,ose njëzëz që u zhvendosën(IDP) dhe më shumë se 100 mijë Serb të Kosovës, u larguan nga provinca në mënyrë të konfliktit,keto përqindje nuk janë shumë të besueshme që nga Janar 2001).

Prodhimi i Brendshëm Bruto i Pergjithshëm(GDP) 1995:

Vlerësuar në 400 USD për koke-më e ulta në Republikën Jugosllave-por një pjesë e madhe e ekonomisë varej nga sektori jo-formal, dhe ekonomia e dobët e shqiptarëve të Kosovës.Bujqësia 29%,Industria 34% tregëtia dhe shitja me pakicë 11%

1. "Levizje urbane" e popullatës,vecanerisht deri Prishtinës, ka ndodhur pas Luftës,për arsye sigurije,punesimi dhe shërbimeve baze,për këto arsye,shpërndarja e tanishme urbane dhe rurale,nuk është shumë e sigurt në shifra.Shumë familje akoma janë në levizje;disa duke u kthyer nga jashtë shtetit,të tjerë duke lënë Kosovën.Shkollat fillorë sipas vlerësime (të Janar 2000)kanë afërsisht 280.000 nxënës,krahasuar me 266.000 në 1999 dhe 305.000 në 1991.
2. Numri total i popullsisë të Kosovës është vështirë të vlerësohet, meqë Shqiptarët e

Kosoves,bojkotuan rregjistrimin e fundit te popullsise ne 1991. Sipas rregjistrimi te meparshem(1981) nga nje popullsi totale prej 1.585.000 banore, 1.227.000 (78%) ishin Shqiptare, dhe 210.000(13%) Serb.

Papunesia: 43.2% ne 1996(shifra e fundit e vleresuar). Vleresimet jo zyrtare flasin per nje perqindje me te larte, deri ne 60%.

Nivelet e Qeverisjes ne Arsim:

Ekzistojne kater nivele ne fushen arsimore: Departamenti Qendror i Arsimit dhe Shkences(DES), pese Administrata Rajonale(Prishtina, Mitrovoca,Gjilan,Peja dhe Prizren 3), 30 Bashki me 1500 fshatra dhe shkolla.(Shenim): Zgjedhjet Bashkiake u zhvilluan me sukses ne 28 Tetor 2000. Zgjedhjet e Pergjithshme ne Kosove priten te zhvillohen ne 2001. Nje Departament i Arsimit dhe Shkences brenda Misionit te Kombeve te Bashkuara ne Kosove(UMNK) i ngritur ne 2000,sherben si Minisitri de facto, sipas nje marreveshje te perbashket UNMIK/Kosovar me dy " Drejtues" nje nderkombetare, dhe nje Kosovar.Pas zgjedhjeve, 2001 pritet te krijohet nje Ministri e Arsimit formale, qe do te dali nga ky insitucion i perbashke UNMIK/Kosovar.

Hyrje dhe Konteksi

Qellimi i ketij raporti eshte i ngushte, ai synon te jape nje pasqyre te pergjithshme te sistemeve arsimore ne vendet e Europes Jug-Lindore, si dhe gjendjen dhe nevojat aktuale. Gjithashtu letersia baze mbi konfliktin e Kosoves eshte e bollshme,dhe keshtu nuk eshte e nevojshme te behet nje diskutim i detajuar mbi origjinen e ceshtjeve politike qe cuan ne konflikt, pervec faktit se ato ndikuan dhe akoma ndikojne ne sistemin arsimor te Kosoves. Per keto arsye do te mjaftonte nje pasqyre e pergjithshme e sfondit historik.

Para Luftes se Dyte Boterore ekzistonin vetem 252 shkolla ne Kosove,ku te gjitha lendet zhvilloheshin ne Serbisht. Kur u krijua Republika Federale Socialiste e Jugosllavise (SFRY) ne 1945, kishte 392 shkolla, te gjitha kishin mesime ne Serbisht,por 292 prej tyre kishin gjithashtu mesime ne gjuhen Shqipe.Keto lende jepeshin nga 300 mesues Shqiptare, 50 prej te cileve te importuar nga Shqiperia. Nje studim i vitit 1948 tregoi se 74% e popullates se rritur te Kosoves ishin analfabete.Me futjen e gjuhes Shqipe ne shkolla(dhe ne disa shkolla dhe gjuhen Turke),rregjistrimet u rriten vazhdimisht deri ne fund te viteve '70, ku 72% e grupmoshave shkollore qe flisinn shqip u rregjistruan. Ne fund te viti 1980, analfabetizmi ra ne 10 /4, megjithese tani eshte duke u rritur perseri per shkak te personave qe kthehen ne vend e qe hasin veshtiresi per tu integruar serisht ne shoqeri.

Ne kohen e shperberjes, ne vitin 1991, Republika Federale Socialiste e Jugosllavise (SFRY) perbehej nga gjashte Republika(Serbia, Mali i Zi, Maqedoni, Kroacia, Sllovenia dhe Bosnja Herzegovina), dhe dy Provinca Autonome (Kosova dhe Vojvodina).Kushtetut SFRYe vitit 1974 u dha ketyre dy Provincave te Drejta te ngjashme 5, me ato te gjashte Republikave, ato kishin Asamblete e tyre Parlamentare dhe Vende ne Parlamentin Federal, megjithese teknikisht ato ishin pjese e Republikes Serbe. Kur SFRY u shperbe ne 1991, Komuniteti Nderkombetare njohu vetem Republikat si Shtete; Kosova dhe Vojvodina mbeten brenda Serbise, dhe formuan se bashku me Malin e Zi, nje "pjese fundore" e Republikes Federale te Jugosllavise (FRY).

Ne kete kohe, kushtet per Shqiptaret e Kosoves u keqesuan me nje rritem shume te shpejte. Tashme ne 1989, Qeveria e Serbise kishte filluar te ndermerte hapa per t'ja hequr Autonomie Kosoves, dhe per te vendosur ne kete Province, kontroll direkt nga Beogradi.

3. Nepunesit e Arsimit te vendosur ne keto pese Rajone perfaqesojne UNMIK/DES.
4. Ata takohen me Drejtoret e Arsimit te Bashkive, per te siguruar zbatimin e politikave arsimore te UNMIK-ut.

5. Noel Malcolm-Kosova-Histori e Shkurter,Londer-Macmillan 1998, f.326
6. Por jo identike.Kishte ndryshime ne gjuhen zyrtare dhe ne te drejtat e vetevendosjes.

Popullata e gjere Shqiptare ne Kosove, u pergjigj me protesta dhe demonstrata, qe u perballen me shpalljen e "Gjendjes se Jashtezakonshme" dhe represion nga policia Serbe.Gjate muajve dhe viteve qe pasuan gjithë pushteti kaloi ne duart e Serbeve te Kosoves, dhe te tjereve nga vete Serbia. Manaxheret Shqiptare te Kosoves, profesionistet, mesuesit, doktoret dhe akademiket u hoqen nga postet e tyre dhe u larguan nga Provinca. Nje nga tiparet kryesore te reagimit te Shqiptareve ndaj shkaterrimit te posteve te tyre ne 1990, ishte rezistenca paqesore dhe kryesisht jo e dhuneshme.

"Konflkti" i fundit ne Kosove, kaloi permes dy fazave te dallueshme: Shkurt-Tetor 1998 dhe Mars-Qershor 1999. Ne 1997 qendrimi i shume shqiptareve ne Kosove ishte forcuar. Nje grup qe e quanin veten Ushtria Clirimtare e Kosoves" (KLA) filloi nje sere sulmesh ndaj stacioneve policore Serbe, dhe objekteve te tjera, policia u pergjigj ne menyre te ashper.Nje pike kulminante u arrit ne fund te Shkur 1998, kur forcat e Sigurimit Serb,filluan nje operacion ne Rajonin e Drenices,ku pati shume te vdekur ne mes te civileve duke perfshire gra dhefemije. Kjo gje radikalizoi dhe me tej popollaten qe kishte shumicen dhe i shtoi rradhet e UCK(KLA). Pavaresisht se ky akt u denua ne plan nderkombetare dhe pati nje embargo armesh mbi FRY nga Keshilli i Sigurimit te Kombeve te Bashkuara, operacionet dhe sulmet vazhduan midis periudhes Mars deri ne Tetor 1998. Ne kete kohe Autoritetet Serbe, shpallen se te gjitha "aktivitetet antiterroriste" ne Kosove kishin perfunduar, pas shpalljes se Rezolutes 1999 nga Keshilli i Sigurimit te Kombeve te Bashkuara,e cila kerkonte nje arme pushim te menjehershem dhe prezencen e monitoruesve nderkombetare ne Kosove.Ne kete kohe Komisioni i Larte Per Refugjate te Kombeve te Bashkuara (UNHCR) vlersoi shifren 294.000 Shqiptare dhe ndoshta me shume,te larguar nga shtepite e tyre,megjithese shumica kishin mbetur ende brenda Provinces.

-
7. Nepunesit e Arsimit te vendosur ne keto pese Rajone perfaqesojne UNMIK/DES.
 8. Ata takohen me Drejtoret e Arsimit te Bashkive, per te siguruar zbatimin e politikave arsimore te UNMIK-ut.

9. Noel Malcolm-Kosova-Histori e Shkurter,Londer-Macmillan 1998, f.326
10. Por jo identike.Kishte ndryshime ne gjuhen zyrtare dhe ne te drejtat e vetevendosjes.

Prezenca e monitoreve te OSCE nuk i pengoi autoritet Serbe te ndermerrnin levizje dhe perleshje te metejshme trupash me UCK (KLA).Pavaresisht nga inisiativat politike dhe diplomatike te zhvilluara ne fillim te 1999, monitoret e OSCE duhej te terhiqeshin me nxitim ne 20 Mars'99, dhe NATO leshoi nje ultimatum ku i kerkonte Serbise angazhim ne marreveshjen e arme pushimit. Ne 24 Mars 1999 forcat e NATO filluan bombardim ajror te objekteve te FRY, dhe Serbia deklaroi “Gjendje Lufte”. Brenda Kosoves, luftimet midis UCK dhe Forcave Serbe(megjithese ne nje nivel tashme me te ulet) vazhdonin gjate gjithe periudhes te bombardimeve ajrore te NATO-se, me sulme mbi popullaten civile, u shtua shume intensiteti i ketyre goditjeve; popullata civile u debua nga shtepite me nje fluks te shpejte ne te gjithe Provincen. Ne 9 Qershor 1999 afersisht 862.000 Shqiptare te Kosoves, nga qytete dhe fshatra ishin larguar nga Provinca, dhe ishin drejtuar drejt vendeve fqinje(Shqiperi dhe Maqedoni), mijra te tjere u zhvendosen brenda vendit. Pamje nga pikat kufitare dhe kampet refugjate ne keto vende cfaqeshin cdo dite ne median nderkomebtare.Me ne fund, ne 10 Qershor 1999, u nenshkrua nje marreveshje; Keshilli i Sigurimit te Kombeve te Bashkuara leshoi Rezoluten 1244, ku autorizohet prezenca e Sigurimit Nderkombetare ne Kosove dhe caktimi i nje Perfaqesuesi special per te vendosur nje prezence civile nderkombetare paralele (UNMK) per te sherbyer si Qeveri i nterim de facto e Kosoves. Sulmet ajrore te NATO-os u nderprene, dhe dy dite me vone Forcat e NATO (Forcat e Mbrojtjes se Kosoves ose KFOR) u vendosen ne Prishtine per te mbikqyrur terheqjen perfundimtare te Forcave Serbe nga Provinca.

Kthimi i refugjateve nga Maqedonia dhe Shqiperia ishte i shpejte.Brenda tre javesh 1/2 milion Kosovare u kthyen ne Kosove; ne Nentor 1999 UNHCR dha nje shifer me shume se 800.000 te kthyer. Ne te njejten kohe, me shume se 180.000 mije njerez, shumica Serbe, por edhe Rome, u debuan ose u larguan nga vendi dhe disa qindra vdiqen.Sipas nje Studimi te KFOR-it te bere ne Vjeshten e vitit 1999, shifra ishte me pak se 100.000 Serbe (5% e Popullates), te cilet mbeten ne Province ne Zona te mbrojtura nga KFOR-i, dhe ne qytete te ndare me dysh si Mitrovica, ku Serbet jetojne ne veri te lumit Ibar, dhe Shqiptaret ne jug(per shkak se eshte afer Serbise, pjesa Serbe e Mitrovices eshte bere ne fakt pjese e vete Serbise). Perleshjet ketu jane te shpeshta dhe trupat e KFOR-it patrollojne uren qe lidh keto dy komunitete.

Dhunimeve te Ligjit Humanitare Nderkombetare ne Kosove, 1999 Bruksel, 2000 f.49.

Sistemi Arsimor

- *Mosha e arsimit te detyrueshem fillon ne 6 vjec* (nga Shtatori 2000,Rregullorja e UNMIK 2000/51).
- *Mosha kur mbaron arsimi i detyrueshem:* 15 Struktura e Sistemit te Pergjithshem Arsimor: Shkolla fillore 5 vjet (nga 09/2001) + Shkolla e Ulet e Mesme 4 vjet (per nje total prej 9 vjetesh, arsim i detyruar baze) + Arsimi i Larte 4 vjet. '7
- *Struktura e sistemit arsimor profesional* : 3 ose 4 vjet pas shkolles baze; provim definitive pas 3 vjetesh; "matura" ose provime perfundimtare pas 4 vjetesh, arsim teknik ose profesional.
- *Pikat e provimeve/te tranzicionit:* Nuk ka provime formale ne fund te klases se peste; pas klases se 9-te, teste ne perfundim te shkolles, me dhenie certificate ne fund te kursit; provime pranimi ne shkollen e Larte(profesionale ose te pergjithshme) ne klases e 10-te; provime "definitive" pas 3 vjet edukim profesional ose provime "mature" (me baze shkollen) ne fund te klases te 13-te; provime pranimi ne universitet te zhvilluara ne fakultete;

Nje tipar dallues i sistemit arsimor ne Kosove ishte ekzistenca, midis viteve 1992-1999, e dy sistemeve te ndara- njera (zyrtare, i vogel), per femijet Serbe te Kosoves, dhe nje (jo zyrtare,i madh) per femijet Shqiptare te Kosoves.Duke filluar nga Marsi 1991, u nderpre financimi i shkollave ne gjuhen Shqipe, dhe kompanite qe botonin tekste shkollore ne gjuhen shqipe, u mbyllen. Ne 1992, autoritetet Serbe debuan 23.000 mesues shqiptare brenda nje dite, dhe vendosen nje program te unifikuar ne serbisht, duke mbyllur keshtu perfundimisht arsimin ne gjuhen shqipe.

Midis viteve 1992-1998, krahas sistemit serb' 8, ekzistonte nje sistem arsimi "paralel" ne gjuhen shqipe, i vetefinancuar. Ne disa raste femijet e shkollave fillore mund te vazhdonin shkollat e tyre, ne rast se shkolla ndiqej dhe nga femije serbe, godinat ishin ndare pergjysem dhe punonin sipas sistemit me turne. Megjithate shume studente te shkollave te mesme dhe universitare merrnin mesime ne ambiente private.Ne vitin 1998, kishte 266.400 nxenes te shkollave fillore, 58.700 nxenes te shkollave te mesme, dhe 16.000 studente universitare ne kete sistem paralel. Parate per te paguar mesuesit vinin nga nja takse te ardhurash prej 3%, qe grumbulloheshin nga autoritete- takse mbledhese, si dhe nga sindikatat ose diaspora Kosovare,(Fondi shteteror ne hije per Republikën e Kosoves grumbulloi donacione te ofruara nga pothuajse te gjithe vendet perendimore, te cilat arriten 30% te buxhetit shteteror). Shkollat paralele megjithese vepronin hapur, dhe ne disa raste dhe toleroheshin nga autoritetet Serbe, shpesh ishin objekt represioni dhe frike. Keto shkolla vuanin nga mungesa e cilesise, numri i nxenesve ra, vecanerisht i vajzave '9. Ne 1996 regjistrimi ne shkollen fillore ishte i ulet, afersisht 12%, regjistrimi ne shkollen e mesme 21%, dhe regjistrimi ne universitet pothuajse per gjysem. Librat ishin nje problem kronik, vecanerisht mungonin librat shkencore, dhe librat e mjekesise ne nivel universitare.

Politikisht, sistemi paralel kishte dhe akoma ka nje force te madhe simbolike. Per shembull, dokumentat qe perdoreshin ne shkollat kishin stampen "Republika e Kosoves"; kjo ishte sfide e hapur per autoritetet Serbe. (Certifikatat e ketij lloji, natyrisht nuk njiheshin nga autoritetet dhe pranoheshin vetem nga Shqiperia).

7. Deri Shtator 2001, struktura aktuale eshta akoma 4+4+4.

8. Nuk ishte hera e pare ne historine e Kosoves, qe shkollat u bene nje instrument rezistence.Ne 1918, pasi trupat Serbe kishin pushtuar serisht Kosoven, shkollat ne gjuhen shqipe u mbyllen. Pastaj 1992, kjo politike vazhdoi: shkollat vazhduan te ekzistonin jo zyrtarisht dhe u kthyen ne qendra te nacionalizmit dhe te arsimit shqiptare ilegal. Librat vinin fshehurazi nga Shqiperia dhe mesuesit paguheshin nga burime

private. See Tim Judah, Kosova: Lufta dhe Hakmarrja, 2000, ff.21-22.

9. Lynn Davies "Arsimi ne Kosove: Raport drejtuar Keshillit Britanik" Universiteti i Birmingham Angli, Gusht 1999 (Dokument i Pabotuar). Ndersa disa studente nuk frekuentonin me shkollen, arsyeja ishte per shkak te emigrimit, vecanerisht te studenteve universitare.

Ceshtje te tjera:

- *Vaferi e madhe materiale ne infrastrukturen arsimore*, per shkak te shkaterrimit gjate krizes te viteve 1998-99, por gjithashtu dhe per shkak te mungeses se burimeve, ndersa sistemi paralel perpiqej te rezistonte ne Kosove. Pervec kesaj, nga numri i pergjithshem i ndertesave te shkollave ne Kosove, (afersisht 950, qe ne shumicen e rasteve perdoreshin nga studente serbe), pothuajse te gjitha ishin te pajisura keq; 15% nuk kishin tualet, vetem 20% e godinave kishin uje. Prandaj, nuk ishte ceshtja qe studentet shqiptare te shkonin ne shkolla serbe te pajisura mire, te gjitha kane mangesi serioze.
- *Shkeputja nga shkolla per shume femije dhe te rinj ne disa bashki, ne fillim te Prillit 1998*. Eshte llogaritur se 95.000 femije u larguan nga shkolla ose per shkak se shkollat u mbyllen, ose u shkaterruan ose sepse familjet e tyre u zhvendosen ne vende te tjera. Gjate kasaj periudhe, rreth 100 shkolla u shkaterruan, ose u demtuan seriozisht. Gjate krizes se refugjateve ne 1999, nuk u zhvillua fare shkolle, megjithese u bene perpjekje per te ndihmuar perkohesisht femijet ne kampet e refugjateve ne Maqedoni dhe Shqiperi. Pas luftes, 290 shkolla (37%) u shkaterruan plotesisht ose u demtuan aq sa nuk mund te perdoreshin me, 800 shkolla u demtuan rende. Shumica e shkollave nuk kishin uje, dhe mungonin mjetet sanitare (disa nuk kishin fare). Reabilitimi emergjent po vazhdon normalisht por pajisjet baze dhe librat akoma mungojne ne cdo shkolle.
- *Paga te ulta te mesuesve dhe mungesa e administratoreve te trajnuar*, megjithese ne sistemin paralel, mesuesit ishin mesuar te punonin ne kushte te veshtira per nje page te vogel ose fare pa pagese, ata e shikonin punen e tyre ne ate kohe si sakrifice patriotike.
- *Dhe si pjese e ndertimit te kombit*, tani megjithate, mesuesit nuk mund te punojne per te kryer reforma ne arsim po te mos paguhen mire. Megjithese mesuesit jane shume te duruar, ata justifikohen kur kerkojne kushte me te mira. Kontratat e reja (shih seksionin mbi mesuesit) jane nje fillim i mire, por nevojitet me shume mbeshtetje dhe trajnim.
- *Mosfrekuentim i shkolles dhe largim nga shkolla*, edhe gjate ciklit te detyruar. Te dhenat mund te mos jene shume te sakta, por ato tregojne se afersisht 80% e femijve te moshes nga 7-15 frekuentojne shkollen, ndersa per grup moshat 16-18 vjec, kjo perqindje bie ne 37-38% '10. Per me teper vazhdimisht nxenesit bejne mungesa nga shkolla, ne rastin kur ai kalon nga nje sistem arsimor ne tjetrin, jo vetem gjate periudhes se tranzisionit nga nje nivel tek tjetri, por gjithashtu dhe brenda se njejtës klase. Per shembull : shifrat '11 e Librit Shkollor per vitin 2000, treguan se pati 35.000 studente ne fund te klases se 4-te ; 29,000 ne fund te klases se tete; e cila shifer ra menjehere ne fillim te klases se 9 ; 13.000-14,000 morren provimet e matures ne fund te klases se dymbedhete, dhe me pak se 5.000 hyn ne shkollat e larta.

11. Shtepia botuese e librit shkollor (shifra te sakta ekzistojne per studentet qe mesojne ne gjuhen shqipe, shifra me pak precise per studente qe studjojne ne gjuhen turke dhe boshnjake, dhe nuk figurojne shifra per studentet serbe.

Te dhenat Statistikore

Te dhenat e arsimit per Kosoven nuk jane shume te besueshme, sepse metodat e grumbullimit te te dhenave ndryshojne, dhe sepse popullata zhvendoset per shkak te kthimit te refugjateve dhe per shkak te levizjes se brendeshme te njerezve '12. Misioni i Kombeve te Bashkuara ne Kosove, UMNİK, vlereson se cdo muaj, rreth 15.000 persona kthehen nga jashte shtetit, nga 100.000 refugjate qe u kthyen nga Gjermania ne pranveren e vitit 2000, 30.000 ishin femije te moshes shkollore.

Tabela 1 Shkollat sipas Llojit dhe Popullates 2000

Lloji Shkolles / Nr.Shkollave / Nr.Student / Nr.Mesuesve / Raport Nx /Mesues / Rap.Nx.Mes	Sipas Grupit Etnik				
Te gjitha Tipet :	1.022+164	401.899	22.490	17.9 : 1	18 : 1
Parafillore	21 Kopshte + 164 Klasa pergatitore ne fillore	12.240	596	14 : 7 27.8 : 1 ne klas pergatitore	Shqiptare 16:1 Turq 13: 1 Serbe 17:1 Shqiptare Turq,Boshnjake 7 : 1 Serbe
Fillore 1-8	919	286.940	15.788	17 : 1	7 : 1 Serbe
E mesme e Pergjitheshme	2,754	31,318	1.929	16 : 1	19:1 Shqiptare
E mesme Profesionale		49.343	3.094	20 : 1	8:1 Serbe
Arsimi I Larte	1 Universitet Perbehet nga 14 Fakultete+7 Shkolla Te larta	22.058	1.083	20 : 1	Nuk dihen

Nje studim i bere nga UNICEF, menjehere pas mbarimit te konfliktit, tregoi se 45 % nga 1000 shkolla te studjuara, ose ishin demtuar seriozisht, ose ishin shkateruar, dhe se shumica e shkollave kishin furnizim te paket me uje te pijshem, me nxehtesi dhe kishin pak mjete sanitare. Prioriteti i pare ne ate kohe, ishte te detyroheshin studentet te ktheheshin ne shkollat,dhe te perqendrohej vemendja ne rikonstruksion, ne riparim dhe ne zevendesimin e pajisjeve shkollore.

12. Rreth 61% e popullates qe eshte zhvendosur me force nga vendbanimet e tyre para Maj 2001. Per komunitetin Serb citohej 13% emigranteve pa arsim. (Studimi Demografik I Kosoves, Rezultatet baze Social-Ekonomike dhe Problemet Shendetore. Organizata Nderkombetare per Migracionin, Maj 2000.

Ne Shtatorin e 2000, u riparuan dhe u rihapen serisht me shume se 400 shkolla, shifrat tregojne se 380,000 studente u rikthyen ne shkollë, shumica prej te cileve jane shqiptare me disa minoritete Serbe, Turke dhe Rome. DES do te vazhdoje te mbaj pergjegjesine e saj, dhe gjate vitit shkollor 2000/2001, duke ja kaluar pergjegjesine Bashkive pas zgjedhjeve bashkiake te Tetor 2000, (shih studimin mbi politiken arsimore, 7 Janar 2001).

Kuadri Ligjor dhe Objektivat e Politikës

Rezoluta 1944, e parashikon Kosoven si nje shoqeri multi etnike, ne nje mjedis te qete e te sigurt. Megjithate ne realitet shume pak shkolla multietnike – ato funksionojne me gjuhe te ndara dhe me turne, keshtu qe ka pak mundesi ose aspak mundesi qe nxenesit dhe mesuesit nga shtresa te ndryshme etnike, te perzihen. Ne pergjithesi, situata nder etnike ka mbetur mjaft e tensionuar vecanerisht ne veri te Kosoves, (qyteti i ndare i Mitrovices dhe zona kufitare e Gjilanit). Komuniteti nderkombetare eshte mjaft i angazhuar per te siguruar nje shoqeri paqesore multi etnike, me nje sisitem arsimor qe ti sherbeje nevojave te shoqerise se re te Kosoves, dhe te reflektojte standartet Europiane moderne. Me mungesen e ligjeshmerise mbi arsimin, shume nga ligjet e vjetra te Jugosllavise aplikohen akoma, te pakten formalisht. Ne praktike sistemi funksionon sipas rregulloreve te nxjerra nga DES, qe ka nje nepunes special ligjor; po pergatiten ligje te reja per arsimin e pergjithshem, per arsimin profesional dhe per organizimin e shkolles, dhe keto shihen si udhezues te teresishem sipas te cilave do mund te zhvillohet autonomia e shkollave dhe e komunave' 13.

UNMIK eshte i anagzhuar per te arritur dy qellime kryesore ne fushen e arsimit; se pari, duke siguruar nje fluks nxenesish me kthim te shpejte ne shkollë, ku te vazhdoje nxenia gjate periudhes se transicionit, deri ne formimin e nje qeverie te zgjedhur ne menyre Demokratike; se dyti, duke mbeshtetur rindertimin afat gjate, dhe transformimin e sistemit arsimor, ne menyre qe ky sistem te jete ne gjendje te mbuloje nevojat e nje shoqerie Europiane moderne.

Dokumenti qe doli nga diskutimi i mbajtur ne Tetor te vitit 1999 , mbi “ Projekti per Sistemin Arsimor te Kosoves, hartoi nje strategji per arritjen e ketyre dy objektivave, dhe per nje kalim te bute nga administrimi interim i UNMIK, ne nje qeverisje lokale, ne sektorin arsimor, Modeli i DESK' 14, kishte per qellim te krijonte nje kuader pune per bashkepunim midis UNMIK, donatoreve, Kombeve te Bashkura, dhe Agjensive nderkombetare, organizatave jo qeveritare dhe administratoreve lokale dhe specialisteve, duke i bashkuar te gjithë keta ne grupe pune. Megjithate kjo metode nuk u zbatua mire ne praktike, dhe tashme eshte zevendesuar nga nje sistem i Agjensive Drejtuese (Agjensi nderkombetare qe kane pergjegjesi per nje detyre specifike), i cili punon nendrejtimin e Departamentit te Arsimit dhe Shkences, i ngritur kohet e fundit nga UNMIK, ne Mars te 2000, i cili pergjigjet per te gjitha ceshtjet arsimore dhe shkencore. DES gjithashtu ka per qellim te koordinoje aktivitetet e Organizatave jo qeveritare, per te siguruar nje efektivitet maximal dhe per te parandaluar nderhyrjet ne kompetencat e njerës apo tjetres organizate.

Per sa i perket politikës arsimore, parimi kryesor eshte arsim inkluziv; dmth, arsim perfshires: te gjithë femijeve dhe te rinjve te Kosoves, duhet tu jepet mundesia per te ndjekur

shkollen. Ceshtje te tjera jane: (1) te ngushtohet hendeku midis mesimit dhe nxenijes, te bazuar ne permbajtje, si dhe mesimit dhe nxenijes te bazuar ne kopetence dhe standarte, dhe (2) arsimi ne dy gjuhe.

Ne Shtatorin e vitit 2000, DES nxorri disa direktiva te rendesishme, u hartua nje kontrate e re per mesuesit, ku nevojitej nje certifikate dhe nje program shkollor, si dhe nje plan mesimor. Kontrata shenonte detyrat e administratoreve te shkolles, mesuesve, stafit mbeshtetes, dhe stafit te mirembajtjes se shkolles. Drejtori i shkolles, sipas kesaj kontrate, ka te drejten per te emeruar stafin dhe eshte pergjegjes per vleresimin e cilesise se mesimdhënies, dhe sigurimin e rritjes profesionale te mesuesve. Objektivat e tjera ishin: (1) te gjithë femijet qe kane arritur moshen 6 vjec ne fillim te vitit akademik, duhen te jene ne shkolle, dhe duhet te perfundojne shkollen deri ne moshen 15 vjec, (2) prinderit do te gjobiten nese ata nuk rregjistrojne femijet e tyre; megjithese do te jepen leje per mosfrekuentim te shkolles ne disa raste, (psh. femijet qe marrin nje perkujdesje shendetsore ne shtepi), (3) cikli primar shtrihet nga 4 deri ne 5 vjet, i pasuar nga 4 vjet arsim para sekondar, per te arritur nje total 9 vjet arsim baze te detyruar, (4) eshte duke u pergatitur nje program qe shpreh reformat ne permbajtjen mesimore, ku UNICEF eshte caktuar te jete agjensia drejtuese ne reformen e curricules se shkolles fillore dhe te shkolles se mesme. Nen kujdesine e Agjensise Kanadeze per Zhvillim Nderkombetar (CIDA), ekspertet jane duke punuar ne trajnimin e mesuesve, i cili do te jete thelbi i reformave te Sistemit Arsimor ne Kosove.

Administrimi dhe Reforma ne Sistemin arsimor

Qeverisja dhe Drejtimi

Sic u theksua me larte, te gjitha funksionet e qeverisjes dhe drejtimit te arsimit ne mbare Kosoven, jane pergjegjesi e UNMIK/DES, me zyre qendrore ne Prishtine, dhe me zyra rajonale ne Prishtine, Mitrovice, Gjilan, Peje dhe Prizren. Per shembull, te gjitha kontratat e mesuesve firmosen direkt nga UNMIK/DES. Qellimi eshte qe te shperndahet pergjegjesia (duke perfshire dhe pergjegjesine fiskale), per arsimin sa me shume te jete e mundur, ne 29 Perfaqesuesit e Bashkive. Zgjedhjet bashkiake u mbajten ne Tetor 2000, dhe tashme jane formuar administratat lokale te arsimit. Dy drejtoret e DES, dhe Ministri Shqiptar i Arsimit, kane nenshkruar tashme nje marreveshje mbi bashkepunimin dhe koordinimin me Ministrine Shqiptare.

Qeverite mund te ndihmojne ne permiresimin e cilesise se arsimit kryesisht duke vendosur standarte, duke mbeshtetur njeri tjetrin me informacion per te permiresuar arrijtet, duke adoptuar strategji fleksibel, per marrjen, perdorimin e informacionit dhe duke monituar veprimtarine. Ne te gjithë boten tendenca eshte qe qeverite e cdo vendi te jene pergjegjese per cilesine e rezultateve, duke deleguar pergjegjesi per informacionin e dhene, dhe per te gjitha proceset e mesimdhënies ne nivel lokal ose shkollor. Kosova ka ende rruge te gjate per te bere para se te rrjeshtohet ne mes te vendeve qe po e zbatojne me sukses kete strategji.

Riperteritja e arsimit ne Kosove pengohet nga veshtiresi ne kohe, nga mungese fondesh dhe nga aftesite e pa mjaftueshme te specialisteve. Zgjidhja eshte te pergatitet sistemi per nje peridudhe te gjate te gjendjes se emergjences gjate zbatimit; nuk do te kete relacione normale pune, do te kete mungese mjetesh, dhe do te kete paga te ulta. "15

Ceshtje dhe Pengesa ne Qeverisje dhe Drejtim

- *Mbi sistemin paralel ose ne hije gjate viteve 1992-1998*, Ky sistem krijoi nje kuptim te forte per inisiative lokale te decentralizuar, pamvaresisht nga mungesa e plote e legjislacionit qendror, ose drejtimit te politikes. Per shkak se ata kane zhvilluar sistemet e tyre arsimore dhe shendetsores per 1 dekae, ata tashme jane organizata jo-qeveritare me e madhe ne bote (NGO)”16. Rivendosja e nje kuadri ligjor per te gjitha Kosoven, pa ja ulur forcen e perfshirjes lokale, eshte nje sfide serioze. Ka pak te ngjare qe administrata e tanishme te jete ne gjendje ose te doje te bashkoje te gjitha keto forca per te vazhduar punen me sistemin e ri

- *Influenca e Politikes Partiake dhe Etnike*- Qeverisja dhe manaxhimi ndikohen thellesisht nga politikat partiake dhe etnike. Per te ruajtur ballancen, caktohen perfaqesues nga partite rivale Shqiptare, te cilet jo gjithnje komunikojne mire me njeri tjetrin. Politika e minoritetit Serb eshte nje ceshtje kryesore; ne fakt tani ne Universitetin e Prishtines nuk ka me studente Serbe, ose personel mesimor Serb, dhe shpesh raportohen shume raste diskriminimi kunder studenteve qe nuk jane shqiptare.

- *Mungesa e drejtuesve profesioniste*- Nuk ka shume menaxhere profesioniste dhe me eksperience, ashtu sic nuk ka as programe trajnimit per ti gjetur ata, megjithese UMNK ka hedhur per diskutim disa propozime.

- *Perfshirja e komisionereve*- UNMIK pati detyren e rende te fillonte punen mbi nje sistem te shkaterruar, dhe te ngrinte nje infrastrukture per te vene ne levizje punen ne shkolla, menjehere. Kosova eshte shume e varuar nga asistenca nderkombetare; vete provinca siguron vetme 40% te te ardhurave per te cilat ajo ka nevojte. Per shembull; ka shume te ngjare qe rrogat te mbeten te ulta per disa vite, pa te drejte pensioni, dhe me sigurim te ulet shoqeror; megjithese UNMIK perpiqet te perfshije komisionere , shume deshira te ligjshme nuk plotesohen. Kjo con ne zhgenjim dhe pakenaqesi; Sindikata e Mesuesve (SBASHK) i kritikon kontratat e reja qe nuk kane pagese per pensionin ose per leje lindje, dhe nuk kane pershkrim pune; prinderit dhe mesuesit ankohen se atyre nuk ju eshte marre mendimi lidhur me programet shkollore; pjesemarrja e komunitetit “nuk ekziston”. Ndryshimi i menjehershem i fillimit te shkolles per femijet e moshes 6-vjecare(qe u lajmerua vetem 2 jave para se te fillonte shkolla), u kritikua gjeresisht. Ky ndryshim pati pasojat e veta dhe ne punen e mesuesve ne klase, ne tekste, transport, dhe ne sistemin e edukimit parashkollor. Komisioneret nuk i parapelqejne vizitat e shumta te ekipeve nderkombetare, gjithashtu ata nuk pelqejne as raportet dhe rekomandimet e tyre qe sic mendojne ata, nuk japin ndonje ndryshim real.

-
- 13- Michael Daxner, Studim mbi Politiken Arsimore, Janar 2001, f.13
 - 14- DESK- Projekti i sistemit Arsimor ne Kosove, Skice Dokument, UMNİK, Seksioni mbi Arsimin, 17 tetor 1999,
 - 15- Deklarate mbi Politiken Arsimore 2001, f.8,
 - 16- Cituar ne Lynn Davies, Arsimi ne Kosove, f. 35.

Barazia ne Pranim, ne Arritje dhe Sukses

Kur Autonomia relative e Kosoves u prish ne 1991, u ndermorr nje numur i madh masash te perkoheshme, per te imponuar serisht sundimin nga Beogradi. Keto masa perfshinin disa rregullore qe cuan ne largimin ose heqjen nga puna te shume shqiptareve ne sektorin publik, gazetari, mjekesi, dhe polici. Ne fushen arsimore, programi Serb u imponua mbi studentet shqiptare; kur mesuesit protestonin, shume prej tyre deboheshin, u vendosen shume kufizime ne numrin femijve, qe do te mesonin shqip, dhe me ne fund policia i ndaloi mesuesit dhe nxenesit te hynin ne shkolla, u ndoq nje politike e racionalizimit, ku per 36.000 femije shqiptare qe mbaronin shkollen 8-vjecare ne 1991, vetem 6.000 vende ishin te lira ne shkollen e mesme (te gjithë studentet Serbe dhe Malazeze regjistroheshin ne shkollen e mesme). Me shume se 860 personel Akademike nga Universiteti i Prishtines, u debuan dhe keshtu ky institucion u kthye ne nje institucion Serbe.

Prandaj te pakten gjate periudhes 1991-1999, mund te themi se nuk kishte barazi per pranim ne shkollë, per arritje dhe sukses brenda grupeve etnike ne Kosove. Megjithate duhet thene, dhe se shume shkolla serbe ishin gjithashtu ne gjendje te mjere, dhe se cilesia ne arsim ishte e ulet per shumicen e studenteve ne Kosove, megjithese mundesite ishin me te mira per disa.

Situata e tanishme perseri favorizon disa grupe perkundrejt te tjereve, megjithese kushtet jane te renda per te gjithë , disa jane me te keqia, per disa, dhe mos frekuentimi dhe largimi nga shkolla, ngre ceshtje serioze rreth *kush sherbehet, (kujt i mungon sherbimi)*. Se fundi, pranim sasijor pa cilesi, nuk mund te quhet pranim ne shkollim. Eshte e kuptueshme se rindertimi material i sistemit ka perparesi, por ceshtja e cilesise ne arsim, per *te gjithë* femijet dhe te rinjte, nuk duhet lene menjane. Nje nepunes nga nje grup minoriteti eshte caktuar ne DES i cili do te vezhgoje, zhvilloje dhe koordinoje te gjitha problemet qe kane te bejne me minoritetet.

Edukimi Special: vetem nje perqindje e vogel e studenteve te paafte mund te ndjekin shkollen. Ka tre shkolla dhe dy departamente ne Kosove, qe kujdesen per femijet me nevoja te vecanta. Numri total i ketyre studenteve, arrin ne 450. Qellimi afatgjate eshte te perfshihen dhe keta femije ne shkollat e rregullta por per momentin. ky opsion nuk mund te behet i realizueshem.

Lenia e shkolles eshte nje problem i madh. Afersisht 7 % e nxenesve te shkolles fillore e lene shkollen para perfundimit, ne nivel sekundar vetem 66% e studenteve qe fillojne shkollen e mesme, e perfundojne ate.”17, 34% jane nxenes qe nuk e perfundojne kete cikël shkollor.

Ceshtje Finaciare

Politika fiskale ne Kosove, ne rrethanat aktuale eshte ne fazen rudimentare. Eshte ekonomi e bazuar ne para ne dore, ku transakcionet tregtare kryen me DM (marka gjermane)

pa monedhen e vendit, pa instrumenta finaciare, me nje sistem krediti dhe sistem bankar te dobet, qe vepron pa ligje te qarta, e ne menyre jo te rregullt, sipas ligjeve te ish-Jugosllavise dhe rregulloreve, nuk terheqin dot investitore te huaj. Buxhetet nuk jane te unifikuara; buxhetet sigurohen nepermjet taksa paguesve lokale dhe mbeshetje nga donatoret, ndersa buxhetet kapitale jane teresisht te siguruara nga donatoret. Grumbullimi i tarifave doganore, dhe i aksisave si dhe i taksave, pengohet shpesh, nga administrimi i kufizuar i taksave, dhe nuk kryhet rregullisht ne mbare vendin. Te dhenat e buxhetit per vitin 2000, parashikojne nje renie 122 milion DM (afersisht 69 milion USD)''18. Per arsimin, shpenzimi i llogaritur per vitin 2000 ishte 93,4 milion DM (afersisht 45,4 milion USD), ose 27% e shpenzimeve te llogaritura.

Opinionet politike nuk bien gjithnje dakort, lidhur me nivelin optimal te shpenzimeve publike per arsimin. Duket se propozimet konvergjojne ne 5-7% te GNP (Prodhimi i Pergjithshem Kombetare), e cila reflekton praktiken ne shume vende, Ka me pak mos-marreveshje rreth dy ceshtjeve qe kane lidhje me njera tjetren: (1) qe investimi publik ne arsimin baze eshte i nevojshem, (2) qe shpenzimet publike duhet ti japin arsimin baze prioritetin me te larte, (p.sh. lidhur me arsimin e mesem jo te detyruar, dhe arsimin e larte), vecanerisht kur regjistrimet jane te ulta.

Tabela 2 Shpenzimet e Qeverise mbi Arsimin dhe Trajnimin

Kategoria	Shuma	Burimi i te Dhenave
-Shpenzimet publike mbi arsimin		
Si % e Produktit te Brendshem te Vendit GDP	-	-
-Shpenzime publike mbi arsimin ne perqindje nga i gjithe shpenzimi publik	28%	Banka Boterore, Shkurt,00
-Shpenzim per arsimin, per cdo student (arsimi fillor)	193 DM	Banka Boterore, Nen,99
-Shpenzim per arsim, per cdo student (arsimi i mesem)	263 DM	“ “
-Shpenzim per arsimin per nivel:		
parashkollor,	5%	Banka Boterore, Shkurt,00
-Arsimi fillor	65%	
-arsimi i mesem	19%	
-arsimi i larte	11%	
-Paga mesatare mujore e mesuesve:		
parashkollor	290 DM	
arsim fillor	290 DM,	
arsim i mesem	318 DM,	
arsim i larte	300-540 DM	Shtator, 2000

Burimi : CEPS Dhjetor 2000.

Sistemi shkollor paralel ne Kosove, krijoi nje praktike tek popullata shqiptare per te mbledhur fonde per shkolla: u krijua nje organizate jo qeveritare e madhe pa fondet e qeverise dhe pa kontroll nga Qeveria, ne fazen e tanishme arsimit financohet kryesisht nga komuniteti nderkombetare, dhe administrohet permes UMNIIK, sepse nuk ka akoma nje baze taksative stabel as ne nivel qendror, dhe as ne nivel bashkiak. Nje politike fiskale lidhet me 29 komunat; keto komuna ndryshojne shume ne madhesi, ne potencial ekonomik, ne te ardhurat per fryme, ne objekte te taksueshme, si toke, biznese, etj, dhe ne kapacitet per te administruar sistemet e tyre taksative.

17. CEPS, Ljubljana Dhjetor 2000,

Dhenia e kompetencave financiare dhe qeverisja e komunave, ne forme grantesh, sipas formules 1, grant per cdo student, do te permiresonte sistemin e financimit te drejte ne te gjithe Kosoven. Kjo do te nxiste gjithashtu dhe bashkite, dhe komunat qe te menaxhonin ne menyre efikase burimet e tyre arsimore, me kusht qe cdo kursim te perdorej per te miren e sistemit arsimor ne komune.

Ne zhvillimin e sektorit privat, ndikojne ndermarjet e vogla dhe te mesme, dhe sherbimet. Tani ne Kosove, nuk ka shkolla private ose institucione arsimore te larta, private,

Currikulat: Qellimet, Shperndarja dhe Arritjet

Standartet dhe Curricula “ 19

Perpara vitit 1990, institucionet arsimore ne Kosove ishin koordinuar ne menyre te pavarur nga Serbia, brenda kuadrit te Pergjithshem te Autonomise, me Ministrine Arsimit, Shkences dhe Kultures se Kosoves, si Organi Administrativ me i larte. Autoritetet arsimore ne Kosove, ishin te lire te zhvillonin dhe te aprovinin curricula, dhe te kontrollonin gjithe sistemin arsimor te Kosoves.

Ne shkollat fillore dhe te mesme, funksionojne paralelisht dy gjuhet: Shqip dhe Serbisht, Kjo e drejte ishte e bazuar ne kuadrin Kushtetues te Jugosllavise, te 1974. Ky kuader Kushtetues, perfshinte rregullore per mbrojtjen e minoriteteve, te cilat i garantonin shqiptareve nje barazi kombetare si te gjithe kombet e tjera te ish -jugosllavise. Pervec kesaj, Turqishtja njihej si gjuhe e trete zyrtare ne Kosove.

Ky sistem arsimor, ku perfshiheshin curriculat, ishte relativisht i sukseshem per rritjen e standarteve cilesore. Per shembull, pas Luftes se Dyte Boterore, numri i personave qe dinin shkrim dhe kendim, ishte shume afer mesatares, brenda ne rajon dhe ne vendet fqinje. Me hapjen e Universiteit te Prishtines 1970, me shume se 60.000 studente u diplomuan, dhe ne vitin 1996, me shume se 60% ishin ne gjuhen shqipe.

Ne vitin 1989-1990, u hoq autonomia e Kosoves. Kjo pati efekte serioze ne sistemin arsimor, duke perfshire dhe te gjitha ceshtjet qe do te trajtoheshin ne programet shkollore. Ne vitin 1991, u anulua legjislacioni mbi arsimin, shkencen dhe kulturen, si dhe autonomia vendim-marrese per curriculat; u vendosen ligjet dhe curriculat Serbe, dhe shkollat fillore dhe te mesme u mbyllen forcerisht. Gjate viteve '91-'92, i gjithe mesimi ne gjuhen shqipe behej ne menyre te fshehte, (ne hije), ashtu sic folem me larte per sistemin paralel.

Curricula e sistemit paralel, sigurisht kishte qellim qe te zhvillonte nacionalizmin shqiptare, ne nivelin elementar dhe seondar, programi i vjeter prej 14- lendesh u mbajt, aq sa ishte e mundur. Shteti hije, u perpoq ta largonte curriculen nga kerkesat e shqiptareve, dhe filloi te importojte tekste nga Shqiperia; Shqiperia ishte i vetmi vend ku njiheshin zyrtarisht dilpomat me vulen “Republika e Kosoves”.Megjithate, Kosova akoma ka curricula qe jane te vjeteruara, dhe te mbushura vetem me fakte; ato duhen modernizuar tashme, dhe te futen ne linje moderne,

ashtu sic ka ndodhur ne vendet fqinje gjate 7-8 vjeteve, “te humbura” per Kosoven, per shkak te izolimit nga reformat ne fushen arsimore. Raportet dhe intervistat e specialisteve

18.

 Banka Boterore, Kosova: Vendosja e Paqes Permes Zhvillimit, nentor 1999, f.7.

nderkombetare, tregojne se ndjehet nevoja per te futur lende te reja, si: qyteterimi, histori dhe gjeografi, pa permbajete propagandistike, nacionaliste, arsim per tolerance, edukim seksual, parandalimi i SIDA, edukim ne lenden e luftes kunder droges, lende e re si arti dhe drama, te cilat ndihmojne ne unifikimin e kombit dhe ndihmojne ne sherimin e traumave te luftes.

Curriculum

Rregullime dhe Pershtatje per Vitin 1999-2000 dhe 2000-2001.

Pavaresisht nga te gjitha perpjekjet dhe rregulloret, ne Kosove nuk ekziston ende nje arsim i unifikuar dhe nje sistem curriculumi. Sistemet arsimore Shqiptare dhe Serbe, dhe komunitetet qe ata ju sherbejne, deri tani kane mbetur si grupime te vecanta, dhe qe te dyja jane nen admnisstrimin e UMNK. Per rrjedhoje, per shqiptaret e Kosoves, ka mbetur sistemi dhe curriculumi i meparshem arsimor, i cili ka funksionuar “gjate modelit paralel” (1991-1999), dhe i cili eshte bere pjese e pershtatjeve te reja pas vendosjes se UMNK. Per studentet Serbe ekziston nje “nensistem” qe akoma varet nga Beogradi, i cili siguron curricula dhe tekste mesimore per shkollat qe frekuentohen nga minoriteti Serbe; pastaj ekzistojne dhe grupe te tjera etnike, si Rome, Boshnjak dhe Turq, te cilet nuk kane sisteme te vecanta, duke filluar nga viti 2000, ato perfshihen ne shkolla shqipe, (per shembull, disa nga shkollat qe u vizituan nga misioni i OECD ne rajonet Peje ose Prishtines). Persa i perket curriculumit ne shkollat shqipe, te cilat mbulojne 90 % ose me shume te numrit total te atyre qe ndjekin shkollen ne Kosove, UMNK dhe autoritetet Kosovare ne fushen e arsimit kane vendosur (te pakten deri ne Shtator 2001), te mbajne curriculumin i cili ishte ne perdorim gjate sistemit paralel.

Strukture e Re per Sistemin Arsimor

Duke u nisur nga viti shkollor 2000-2001 ndodhi nje ndryshim i rendesishem, i cili do te influencoje ndjeshem ne zhvillimin e curriculave. Cikli i Pare i shkolles fillore u shtri ne 5 vjet, duke filluar ne moshen 6 vjecare. Ne klasen e gjashte studentet fillojne Ciklin e Dyte te arsimit tetevjecare (qe quhet ngandonjer, Shkolla e Mesme e Ulet), arsimi 4 vjet; mesues te ndryshem japin te gjitha lendet. Curriculumi perfshin gjuhen amtare, nje gjuhe te huaj (ne shumicen e rasteve anglisht), matematike, biologji dhe fizike, (duke u nisur nga klasa e 6), kimi (duke u nisur nga klasa e 7), histori, gjeografi, edukate civile, arte, dhe edukate fizike. Shkolla e Mesme e Pergjitheshme 4 vjecare, vazhdon po ne te njejtat linja, me disa lende plotesuese, rreth 15 ose 16.

Cilesia e Curriculumit

Per shkak te veshtiresive qe kaloi Kosova ne vitet 1990-1999, curriculat ekzistuese per lende te ndryshme, jane shume enciklopedike, kane permbajtje njohurish dhe perqendrohen ne dhenie informacioni, ndersa ne vende te tjera, qellimet e curriculumit jane: zhvillimi i aftesive njohese te studenteve; curriculumi ofron pak mundesi per te mesuar dhe per te fituar eksperience. Ky curriculum bazuar ne lende ku ofrohen vetem njohuri, pengon edhe

shkembimin e njohurive midis lendeve te ndryshme, si dhe pune krijuese pertej permbajtjes se curricules. Studentet nuk mund te zgjedhin lendet qe preferojne, megjithese shume prej tyre e kerkojne nje gje te tille; ndihet nevoje te modernizohen lendet tradicionale, dhe ne to te futen me shume probleme njohese dhe shoqerore, qe do te perqafoheshin nga shumica e studenteve, DES ka filluar te rishikojte permbajtjen e curricules per arsimin e pergjithshem, por ndihet nevoje te zbatohen metodat dhe procedurat e reja ne zhvillimin e curriculimit dhe ne praktiken e mesimdhenies.

Metoda te Mesimdhenies dhe Nxenes

Sistemi arsimor qe Kosova trashегоi nga e kaluara, eshte shume i ngurte per sa i perket metodave te mesimdhenies dhe te te mesuarit; kjo ka ndihmuar negativisht ne cilesine e mesimdhenies dhe ne tere procesin edukativ ne teresi. Per shkak te izolimit ne dekadene e kaluar, sistemi arsimor ne Kosove, nuk mundi te perfshinte ndryshimet e medha ne fushen arsimore (vecanerisht ne didaktike, ne praktikate e mesimdhenies, dhe ne pedagogji) te cilat kane ndodhur ne OECD ose ne disa vende ish komuniste te Europes Qendrore (Hungari, Polono, Republika Ceke, Slloveni, Rumani.)

Klasat shpesh jane te medha dhe jane te mbingarkuara me nxenes; disa ne Skenderaj, jane klasa te vendosura ne disa kasolle te perkoheshme. Mesuesit, shume prej tyre te pakualifikuar, japin 20 ose me shume ore ne jave; nxenesit kane 5 ose 6 lende cdo dite, afersisht 24-30 ore ne jave. Studentet e ndjekin shkollen me turne- disa shkolla kane 2 turne dhe disa 3 turne. Per kete arsye nuk vendosen lidhje te ngushta midis mesuesit dhe nxenesit, dhe nuk ka perqendrim te mjaftueshem te vemendjes ne klase. Mesimdhenia, kryesisht behet sipas stilit “autoritar”, “frontal”, ose “dhenie udhezimesh”, pra predominon modeli me ne qender mesuesin. Mesimi permendesh eshte i zakonshem, vemendja nuk perqendrohet ne pune krijuese, dhe ne punen ne grup, ne debat, zgjidhje problemi, pune kerkimore, ose aktivitet mbi projekte. Mesuesit perdorin metoden e leksionit dhe studentet perpiqen te mesojne permendesh materialin. Perjashtime jane vetem disa raste, kur jane zbatuar programe eksperimentale te filluara nga disa organizata jo qeveritare ne disa shkolla, si dhe nje numur inisiativash lokale.

Sigurimi i Teksteve Shkollore dhe Mjeteve te Mesimdhenies

Tekstet mesimore ne pergjithesi jane importuar nga Shqiperia ose jane hartuar ne Kosove gjate sistemit paralel. Autoret kompetente dhe me eksperience, jane te pakte ne numur dhe shume hartues tekstesh me potencial shkencor nuk kane patur mundesi te tregojne aftesite e tyre. Disa donatore kane ndihmuar me fonde ne ribotimin e teksteve shkollore ekzistuese, te pakten per lendet kryesore, te ciklit primar dhe sekundar. Keto tekste u perdoren gjate vitit 1999-2000 dhe 2000-2001, duke lene shteg per nje rishikim te metejshem te curriculimit dhe teksteve ne vitet e ardheshme. Shume shkolla nuk kane materiale baze mesimore ose materiale laboratorike, si mtariale mbeshtetese, pajisje per edukaten fizike, ose mjete te tjera mesimdhenie; per kete arsye studentet mesojne me shume teori se sa praktike. DES synon te pajise labororet e shkences me pajisje laboratorike baze, per vitin 2000-2001.

Reforma ne Curriculum

Ne Korik te vitit 2000, UNMIK/DES perqafoi konceptin e “Agjensive Drejtuese”. Keto agjensi konsiderohen si organizma kryesore teknike dhe koordinuese ne sektore te ndryshem. Keto jane te vetmet agjensi. UNICEF u ftua qe te marre pjese si Agjensi Drejtuese ne hartimin e curriculave se bashku me Byrone Nderkombetare te Arsimit (IBE)’20. Perzgjedhja e grupit baze te zhvillimit eshte reklamuar shume, dhe ne te ardhmen do te organizohet nje trajnim fillestar per kete grup kryesor si dhe nje workshop nderkombetare per tendencat ne Zhvillimin e

Curriculumit. Ne Gusht te 2000, DES aktivizoi nje nepunes per zhvillimin e curriculumeve, ne mbeshteje te ketij procesi, dhe per koordinimin e te gjithe punes ne proces. Afati perfundimtar per hartimin e kuadrit te curriculumit eshte vendosur ne Qershor 2001, zbatimi do te filloje ne vitin shkollor 2001-2002' 21 .

Nderkohe nje numur inisiativash ne shkolla dhe nga "larte poshte" , kane filluar ta ndryshojne curriculumin. Me shume se 100 Organizata Jo-Qeveritare po punojne per te permiresuar mesimdhenien brenda nje afati te shkurter, duke perdorur, per shembull, curricula te reja si programi "step by step" te Fondacionit Per Shoqeri te Hapur, i cili perfshin mesues, drejtore, studente dhe prinder, dhe i cili ka patur suksese ne vende te tjera te Europes Qendrore dhe Lindore.

Perveç kesaj, Mbeshtetja Finlandeze per Zhvillimin e Arsimit ne Kosove (FSDEK), qe filloi ne Shtator te 2000, ka per qellim te permiresoje cilesine e arsimit ne institucione me nevoja te vecanta. DES koordinon perpjekjet e OJQ-ve dhe Projekteve Nderkombetare.

Vleresimi dhe Provimet

Ne sistemin e vjeter ne Ministri nuk kishte funksion vleresim dhe provimi; ky funksion zhvillohej ne shkolla. Shkollat i dergonin rezultatet e tyre ne institutet pedagogjike te cilat nga ana e tyre pergatisnin nje raport te pergjithshem per autoritet arsimore te Bashkive. Te gjitha keto te dhena bazoheshin ne vleresimin gojor te studenteve, ku kishte pak ndryshim per sa i perket niveleve te arritjes. Komponenti arsimor mbi Projektin per Arsimin dhe Shendetin ne Kosove, qe financohet nga Banka Boterore, perfshin formimin e nje njesie te vogel (brenda UNMIK/DES) me staf te perbere nga specialiste te pergatitur per te matur dhe monitoruar cilesine e rezultateve edukative. Ky organizem, do te kryeje vleresime ne baze kombetare, ne disa fusha kryesore. Nje tjetere komponent i ketij projekti eshte ngritja e Sistemit te Informacionit per Menaxhimin Edukativ.

DES boton udhezime lidhur me certifikatat dhe diplomat qe jepen pas perfundimit te shkolles (DES [1] 1/2000 12/6/00), por praktikat jane pak a shume si ato ne sistemin e vjeter. Shkollat fillore organizojne teste te krijuara nga vete mesuesit e shkolles ne fund te klases se 9-te. Pasataj leshohet nje certifikate (certifikate shoqeruese per masat 29.000 '22). Provimet e hyrjes ne klasen e dhjete (klasa e pare e shkolles se mesme) mbahen per tu rregjistruar ne shkolle (permasa 21.000). Instituti i dikurshem pedagogjik ne Prishtine, hartoi disa tekste model qe u botuan ne forme broshure, dhe qe perdoren nga mesues dhe nxenes (per shembull, ne matematike) si materiale mesimore. Provimet e shkolles se Mesme (maturita) jane me shkrim dhe me goje, dhe korrigojhen nga mesuesit (permasat 13-14.000). Llojet e pyetjeve jane te perzjera; ne matematike dhe shkence, pyetje me pergjigje perzgjedhese, pergjigje te shkurtra, si dhe pyetje me pergjigje te gjate. Ne lendet humanitare zakonisht perdoren esset.

Cdo Fakultet i Universitetit organizon provimet e veta te pranimit. Keto provime zakonisht kontrollojne njohurite baze faktike dhe nuk kane per qellim te vleresojne aftesite e nxenesve per te ndjekur nje program akademik, (per kete arsye nuk ka shume kuptim te vazhdohen keto provime, plus provimeve te stilit te ri maturita, sapo ato te jene te krahasueshme dhe me nje cilesi te mjaftueshme).

Rezultatet e provimit te pranimit percaktojne 70% te renditjes per pranimin e studentit; 30 % percaktohet nga provimi i matures. Fakultetet qe kane nje numur me te vogel aplikantesh se sa numri i vendeve te mundeshme, (per shembull, Fakulteti I Minierave Mitrovice' 23) perdorin nje kriter jo kaq strikt. Studentet qe nuk e marrin provimin, mund ta japin perseri provimin ne vjeshte. Zakonisht rezultatet e provimit te pranimit per nje fakultet nuk njihen nga nje fakultet tjetere. Studentet qe dolen mire ne Olimpiaden qe mbahej cdo vit ne disa lende

(matematike, fizike dhe histori) kane avantazh per tu rregjistruar ne Universitet. Ne Mars 2000 Administratori Nderkombetare i Universitetit te Prishtines, nxorri disa udhezime per pranimin e studenteve te rregullt ne Universitet dhe ne shkollat te larta (IA [I] 3/2000) ku thuhej, se te gjitha ata qe mbarojne shkollen e mesme ne Kosove, mund te pranohen ne Universitet, mbasi te kene dhene provimet e pranimit, per fakultetin e mjekesise, edukaten fizike, inxhinjeri elektrike, inxhinjeri mekanike, arkitekture dhe arte, ose per nje fakultet ose shkolle te larte, ku numri i vendeve eshte me i ulet se sa numri i aplikanteve.

Ceshtje dhe Pengesa ne Curriculum, Standarte dhe Vleresim

- *Procesi i tanishem i ndryshimit* eshta e para reforme e vertete ne curriculumet per mbi 25 vjet; kemi shume per te bere, por nuk kemi shume kohe sepse DES dhe edukatoren lokale, duan te modernizojne curriculumin sa me shpejte te jete e mundur. Per kaluar nga metoda e vjeteruar me baze permbytjen, drejt metodes me baze rezultatet, do te nevojitet me shume kohe; ka gjithashtu dhe nje rrezik tjetër se mund te perseriten gabimet e kaluara.
 - *Te metat e sistemit te centralizuar te curriculumit*, qe bazohen kryesisht ne permbytjen e teksteve, e mbysin inisiativen e zhvillimit te curriculumit qe ka per qellim te nxise potencialin intelektual te studentit, vete zhvillimin, punen ne ekip, dhe komunikimin.
 - *Ndryshimi ne curriculum ne njerin sektore te sistemit* do te ndikoje ne te gjitha sektoret e tjere. Universitetet dhe Institutet e pergatitjes se mesuesve duhet te ndryshojne ne menyre rrenjesore dhe te mendojne serisht per rolet e tyre. Permbi te gjitha, duhet te ndodhin ndryshime ne klase. Duhet rishikuar gjithashtu dhe roli i mesuesit. Mesuesi duhet konsideruar si profesioniste qe eshte ne gjendje te jape maximumin e forcave te tij per te ndihmuar studentet ne plotesimin e qellimeve edukative.
 - *Ka mungese aftesie profesionale*, dhe vizioni startegjik edhe ne stafin e UNMIK/DES. Gjithashtu mungon koordinimi ndermjet agjensive drejtuese dhe UNMIK/DES.
 - *Unifikimi i curriculumit per arsimin e pergjithshem*. Ka arsye te forta politike qe te mos krijohet nje curriculum i unifikuar. Megjithate nje kuader curriculumi i qarte, koherente dhe i vlefshem, eshte i nevojshem dhe mund te pranohet. Per arsye demokratike te pergjithshme dhe per arsye politike, minoritet ne Kosove, sidomos ato Serbe, duhet te kene te drejte te marrin mesime ne gjuhen e tyre, dhe curriculumi duhet ti pershtatet ceshtjeve te minoritetit dhe ndryshimeve.
20. Shih proces verbalin e Mbledhjes Mbi Zhvillimin e Curricules, Prishtine, DES, Shtator 2000
 21. Kuadri kohor eshte shume i ngushte dhe ndoshta nenvlefte son veshitiresite qe kane te bejne me perfshirjen e 1 viti shtese per 6-vjecaret. Efektet do te ndihen gjate gjithes sistemit.
 22. Permasat e certifikatave shoqeruese, jane marre nga: “Arsimi ne Kosove: Nga Kriza deri ne Rimekembje dhe Transformim”, Shkruar nga Machael Daxner, (material i pergatitur per Mbledhjen e Paktit te Stabilitetit mbajtur ne Graz’ 2000.
 23. Mbas mbylljes se Minieres se Plumbit dhe Zinkut, rregjistrimet ne kete fakultet ndoshta do te bien edhe me shume. Te dhenat e fundit kane qene shume te ulta per disa vite: vetem 6% e studenteve te vitit te pare, arrijne deri ne perfundimin e shkolles, ndersa vetem 1/3 e tyre gjejne pune ne profesionin e minoritetit. Megjithate nuk ka akoma plane per ti kaluar keto

aktivitete ne fusha te tjera, te cilat kane nevojte per staf shume te kualifikuar, si ne heqjen e mbeturinave dhe ne pastrimin e territorit.

- *Pershtatja e curriculumit dhe vazhdimesia.* Nuk ekziston nje vazhdimesi sistematike brenda curriculumit aktual. Qellimet per arsimin fillor, te mesem dhe te larte, nuk jane te percaktuara; gjithshu nuk jane te percaktuara as objektivat e pergjithshme dhe specifike, dhe rezultatet e lendeve te ndryshme. Nuk ka nje vazhdimesi konceptuale dhe strukturore per lendet e ndryshme. Meqe po te flasim ne pergjithesi, permbajtja e planit mesimor, dhe temat e ndryshme ne te, shihen si te izoluara dhe thjesht si lende te shkeputura, pa krijuar nje integrim nepermjet lendeve.
- *Aplikimi i standarteve Europiane.* Thuhet se qellimi perfundimtare ne curriculum, ne pergatitjen e mesuesve dhe ne zhvillimin institucional duhet te jete zbatimi ne praktike i “ standarteve Europiane”. Megjithate, rralle eshte kuptuar drejt se cfare perfaqesojne keto standarte. Disa shembuj, qe jane dhene kane qene thjesht nje shkeputje nga modeli i leksionit drejt te mesuarit “bashkeveprues”; shkenca eshte konsideruar si nje lende e vecante qe ka zevendesuar lende si kimia, biologjia dhe fizika; gjithashtu jane futur dhe lende te reja, si edukata qytetare. Ne raste te tjera termi “standarte europiane” i referohej cilesise se godinave, pajisjeve mobilimit, kompjuterave, dhe disa here dhe rrogen se meuseve. E vertetea eshte se termi standart ndryshon dhe ne Europe nga vendi ne vend, dhe nuk duhet harxhuar kohe per te imituar krejtesisht praktikat qe nuk perputhen me realitetin ne Kosove, ose praktike qe nuk kane koherence me njera tjetren. OECD ka vene dukje disa objektiva qe mund te jene udhezime te dobishme.
- *Mbingarkesa e teksteve dhe e punes se nxenesit.* Curricula permban shume lende te vecanta: 14 lende zhvillohen deri ne fund te arsimit fillor, dhe 16 deri ne fund te arsimit te mesem. Keto lende permbajne vetem fakte, dhe kjo krijon nje mbingarkese. Kjo gje ka dhe nje ndikim negativ per metodat e mesimdhencies; per marrjen e njohurive dhe te kuptuarit, si esdhe per pergatitjen e nxenesve per pune, ose per te marre arsimim te metejshem.
- *Ceshtjet qe lidhen me shumicen e nxenesve.* Ndihet nje tendence per te lidhur curriculen e shkolles se mesme me ate te arsimit te larte. Megjithate ne relaitet kjo vlen vetem per nje numur te vogel studentesh (vetem 4,545 studente u pranuan ne universitet ne 2000, per shembull) ndersa pjesa me e madhe duhet te pergatiten per pune. Cvendosja e vemendjes nga programi me baze permbajtjen ne mesimdhencie. Ku ne baze qendron aftesimi I nxenesve, eshte shume I rendesishem ne kete nivel, dhe eshte mjaft I dobishem dhe per ata qe do te vazhdojne shkollen e larte.
- *Nevoja per te perfshire mesues ne hartimin dhe zhvillimin e curricules, dhe ne permiresimin e atmosferes ne shkolle.* Studimet bera kohet e fundit, tregojne qarte se permiresimi I curricules ne shkolle nuk duhet bere thjesht nga nje ndryshim larte posht, por grupi kryesor qe mund ta beje kete ndryshim, eshte grupi I mesuesve dhe administratoreve ne te gjitha shkollat. Ata duhet te mesojne dhe te ndryshojne se bashku, nese e kuptojne se duhet te permiresohet klima ne shkolle vazhdimisht.

- *Nevoja per te perfshire programe psiko-sociale ne curriculum.* Curriculumi duhet ti pergjigjet traumave te renda qe pesoi populli i Kosoves(shumica prej tyre femije) gjate krizes se viteve 1998-99. Qellimi eshte te njihen dhe te sherohen plaget e se kaluares, tre kaperxehen barrierat etnike sa me shume te jete e mundur dhe te ndertohet nje baze per parandalimin e perplasjeve nder etnike ne te ardhmen.
- *Mungesa e procedurave dhe te dhenave per monitorimin dhe krahasimin e rezultateve ne arsim: mungesa e te dhenave vleresuese per politiken arsimore.* Ne Kosove nuk ekziston nje sistem i monitorimit te rezultateve, gjithashtu nuk ekzistojne standarte te qarta qe te sherbejne si baze per krahasim; zyrtaret nuk e kane te qarte pse duhen keto krahasime ku do te vihen ne dukje puna e dobet, dhe do te merren vendime.
- *Mungojne vlersimet efikase dhe procedurat e provimit.* Mesuesit perpilojne testet e tyre duke perdorur ne shumicen e rasteve testin gojor. Nuk ekziston mbeshetjetje profesionale dhe nuk ka standarte per te krahasuar arrijtet e tyre me ato te mesuesve te tjere. Provimet e pranimit ne universitet nuk japin ndonje informacion te dobishem qe mund te perfthohet nga provimet ne mbarim te shkolles profesionale; “provime te dubluara” te ketij lloji jane pa efekt, te kota, harxhojne kohe dhe jane barre per studentet.

Personeli Arsimor

Mesuesit

Sic theksuam me larte, shume mesues dhe profesore ne Kosove, u debuan nga puna pas vendosjes se kontrollit nga Beogradi ne vitin 1990, dhe ne Mars, 1991 qeveria Serbe nuk paguante me rrogat mesuesve qe kishin mbetur. Kjo gje shenoi fillimin e sistemit arsimor paralel (ne hije), qe ka lene gjurme dhe ne ditet e sotme; shume inisiativa qe kane per qellim te permiresojne kapacitetin dhe efikasitetin e stafit mesimor, kane lidhje me ato vite te sistemit paralel.

Gjate tete viteve, mesuesit qe jepnin mesim ne shqip, u privuan nga pergatitja e tyre profesionale dhe nuk ecen krahas zhvillimeve te reja ne fushen arsimore. Shume mesues te pakualifikuar dolen vullnetare, dhe u bene personel mesimor, duke u munduar te zhvillojne aftesite e tyre ne pune e siper. UNMIK tani po nenshkruan kontrata te reja me te gjitha mesuesit (nga Shtator - Dhjetor 2000) si pjese e nje riorganizmi sistematik. Ata mesues te cilet nuk mund te provojne kualifikimet e tyre me ane te nje certificate apo reference, do te marrin statusin e “mesues provizor” 24, ne qoftese ata jane dakort te rregjistrohen ne nje kurs pergatitor per zhvillimin e tyre profesional. Pra eshte e qarte se kurset e zhvillimit intensiv te mesuesve jane te nevojshme per te gjitha, jo vetem per mesuesit provizore. Problem lind me mesuesit Serbe, te cilet fillimisht refuzuan te nenshkruanin kontratat e reja. (Nje arsye ishte se po te firmosnin do te humbnin pagesen qe akoma e marrin nga Beogradi; arsye tjeter eshte presioni i madh qe ushtrohej nga drejtuesit e tyre qe te mos e pranonon kete rregull te UMNK). Megjithate, rreth 1000 mesues Serbe i kane nenshkruar tashme kontratat (Shkurt 2001), dhe duket se ka me pak kundershime ne kete drejtim.

Kuadri Mesimor ne Kosove

Numri total i mesuesve ne te gjitha sektorin arsimor ne Qershor 2000, ishte 28.625 (Tabela 3). Shume mesues qe u futen ne sistemin paralel akoma japin mesim ne shkolla. Nuk ka te dhena precize per raportin e sakte midis mesuesve te kualifikuar dhe atyre qe u mungon

pergatitja e duhur. DES vlereson se raporti eshte 3: 2, qe do te thote se ne nje rajon mbi 50% e stafit aktual mesimor mund te jete i pakualifikuar. DES po harton sataistika qe do te japin shifra me te sakta. Megjithate shume mesues i kane humbur dokumentat dhe certifikatat e tyre te para, kur ju dogjen shtepite dhe pasuria gjate krizes se viteve 1998-1999.

Ne disa pikpamje, karakteristikat e profesionit te mesuesit ne Kosove, ndryshojne nga ato ne vende te tjera, **se pari**, raporti midis mesuesve femra dhe meshkuj eshte 1/3 femra dhe 2/3 meshkuj. Ne nivel te trete, 88% e mesuesve jane meshkuj, dhe raporti sipas gjinise bie me nivelin e arsimit (44% e mesuesve te fillores jane meshkuj, DES 1999). Sipas te njejtit burim 86% e personelit shkollor ndihmes jane burra, dhe shumica e drejtoreve te shkolles dhe menaxhereve ne bashki dhe komuna jane burra.

E dyta, praktikisht te gjitha mesuesit punojne ne shkolla me me shume se nje turn. Ne Prishtine dhe Mitrovice, dhe disa zona te tjera urbane, shkollat funksionojne me 4 turne, dhe jane shume te mbingarkuara. Shifrat e fundit tregojne se me shume se 25% e te gjitha shkollave ne Kosove, operojne me tre ose 4 turne; kjo ndikon shume ne kushtet e punes se mesuesve dhe ne cilesine e mesimdhënies. Klasat jane te mbingarkuara, dhe pothuajse mungojne fare mjetet e mesimdhënies, ose ka fare pak. Mungesa e teksteve bashkkohe eshte nje nga problemet me serioze; vetem ne disa raste te vecanta shkolla mund te siguroje ambiente dhe mjete per mbledhjen e mesuesve dhe per pune te perbashket planifikuese. Natyrisht demtimi dhe shkaterrimi per shkak te bombardimit gjate luftes, jane shkak kryesor. Shkollat gjithashtu u grabiten ne menyre vandale, dhe shume prej tyre akoma nuk jane reabilituar.

Tabela 3 Numri i Mesuesve per cdo Nivel Arsimor

Rajoni	Prishtin	Prizren	Peja	Gjilan	Mitrovica	Total
Parafillore	266	54	139	151	183	793
Fillore	5692	4230	3544	4311	3132	1928
E mesme	2086	1045	1053	1344	957	957
Shkollat me konvikt	7	16	24	0	27	74
Shkolla speciale	13	82	29	0	34	158
Universiteti I Kosoves	108	0	0	0	0	108
Bibliotekat	79	0	0	0	0	79
Administrata	5	14	0	0	0	19
Total	300	158	107	345	1153	28625

Burimi: Departamenti i Arsimit dhe Shkences, Qershor'2000.

Se treti, shume mesues kane punuar per vite te tera me paga shume te ulta, ose pa pagese fare. Mesimdhënia ne sistemin paralel konsiderohej si mbajtja gjalle e gjuhes shqipe dhe kultures nen presinin e qeverise ne pushtet. Per kete arsye dhe mesuesit e pakualifikuar kishin

nje status te mirenjohur dhe te respektuar ne shoqeri, dhe kjo dukuri akoma ndikon ne debatet dhe diskutimet lidhur me reformen ne sistemin arsimor. Administrata e UMNIK u ka paguar

24. Ne Prizren, rreth 60% e personelit mesimor te rregjistruar ishin te pakualifikuar, ndersa 10% ose ishin rregjistruar dy here, ose nuk ekzistonin te rregjistruar.

honorare mesuesve, po keto pagesa kane qene te ulta dhe te barabarta per te gjithë. Mesuesit e kualifikuar te gjuhes dhe specialistet e kompjuterave, jane larguar nga profesioni i mesuesit dhe kane filluar pune me paga me te mira. Per me teper meqe nuk ka patur parapergatitje profesionale te mesuesve, gjate viteve '90, shume pak te rinj kane filluar profesionin e mesuesit.

Se katerti, dhjetra mijra Shqiptare jane kthyer ne Kosove. DES vlereson se ne vitin 2000 rregjistrimi i nxenesve ne sistemin arsimor u rrit 10%; kjo perbente sfide te madhe jo vetem per vete sistemin arsimor, por dhe per mesues te vecante qe duhej te drejtonin klasa te medha, ku kishte studente me origjina dhe eksperienca nga me te ndryshmet. Keta studente qe u kthyen ndihmuan mesuesit, se ne shume raste ata flisnin dhe gjuhe te tjera, si gjermanisht, fergjisht dhe anglisht, dhe kishin zoteruar njohuri baze ne teknologjine e informatikes, dhe ishin ne gjendje t'u "mesonin" dhe nxenesve te tjere kulturen e vendeve ku ata kishin jetuar.

Se fundi, Unioni i Arsimit, Shkences dhe Kultures ne Kosove, UESC, (Sindikata e Bashkuar per Arsim, Shkence dhe Kulture e Kosoves, SBASHK) ka nje rol te vecante ne reformen arsimore ne Kosove. UESC eshte Sindikata e Mesuesve qe bashkevepron ne menyre aktive me DES per te permiresuar kushtet e punes se mesuesve. DES gjithashtu kerkon mbeshtetjen e tyre per zbatimin e nje strategjie te decentralizuar. Ajo ka nje rrjet lidhjesh nderkombetare qe perbejne nje burim te rendesishem novator. Prandaj UESC luan nje rol kyc ne zhvillimin e ndryshimeve ne fushen arsimore, qe nuk eshte nje gje e zakonshme per sindikatat ne vendet e tjera. Gjate vitit 1990 UESC dha mbeshtetje morale dhe materiale sistemit paralel. Problemi aktual i UESC eshte reduktimi i numrit te personelit mesimor ne Kosove- mendohet se 10% e personelit do ta lene profesionin si edhe 50% e stafit ndihmes.

Rroga dhe Pagesa

Problemi i rrogës së mesuesit paraqet nje dileme. Nga njera ane, mesuesit jane mesuar te punojne ne kushte te veshtira, me page te ulet; ata e konsideronin punen e tyre si "sakrifice patriotike" dhe si "kontribut ne ndertimin e atdheut", nga ana tjeter, mesuesit nuk mund te punojne ne nje sistem te reformuar nese nuk paguhen mire. Megjithese mesuesit jane shume te duruar, ata justifikohen kur kerkojne kushte me te mira.

Gjate dhe pas krizes, mesuesit nuk u paguan deri sa UMNIK pagoi honorare per mesuesit ne Shtator 1999 (DM.200 per 1 Shtator deri 31 Dhjetor 1999). Nga Janar 2000 filloi aplikimi i nje pagese te re per mesuesin: rektori i Universitetit merr DM.600 ne muaj, profesoret me kohe te plote: DM.429, mesuesit e shkollave te mesme DM.318, mesuesit e shkollave fillor DM.291. Ne pergjithesi UNMIK eshte ne gjendje te paguaje mesuesit ne kohe.

Honoraret e para terhoqen nga rreth 2000 "mesues fantazem". Keta ekzistojne vetem si emer, por ne fakt nuk punojne ne shkolla. Shumica e ketyre "fantazmave" jane eliminuar tashme, por derisa te perfundojne procedurat e berjes se kontratave te reja, DES eshte e ndergjegjshme qe disa mesues qe e kane emrin ne listen e pagesave, bejne pune te tjera, marrin page dhe atje, Sistemi finaciar qe eshte kaq i dobet ne Kosove, natyrsht nuk mund ta mbaje nje ngarkese te tille te dyfishte.

Sistemi i ri i pagave, bazohet mbi nje kontrate formale me rrogen baze plus shtesat. Ka mundesi te dalin tre lloj kontratash: me kohe te plote, me kohe te pjeseshme, dhe te perkoheshme. Qellimi eshte te transferohen sistemi i pagesave ne 29 bashkite. Mesuesit qe kane kualifikimin e duhur jane kategoria e pare e preferuar. Kategoria e dyte, jane mesuesit qe nuk jane te kualifikuar por jane te afte per te dhene mesim (te ashtuquajturit mesues provizor), ata mund te fitojne nje kontrate per 1 vit, por duhet te bien dakort qe duhet te vazhdojne kurs kualifikimi ne Universitetin Prishtines. Kategoria e trete perfshin ata mnesues qe nuk jane as kmpetente, as te kaul.ifikuuar, por punojne si mesue ne shkolle. Kontaratat mund te behen vetem me dy kategorite e para te mesuesve, duke ulur ne kete menyre numrin e mesuesve te pakualifikuar ne sistemin arsimor.

Ne Shator 2000, DES dergoi 20.000 kontrata duke e reduktuar numrin e personelit ne 6.000 mesues. Pozicioni i “ pedagogut” u zhduk. Rrogat paguhen vetem pasi te jete nenshkruar kontrata . U vendos qe te punohej vetem 40 ore ne jave, dhe kjo ishte nje goditje per mesuesit qe ishin mesuar te punonin 20 ore ne jave. U vendos qe mesuesit do te paguheshin sipas shkalles se cilesise ne mesidhenie, ne cdo Bashki. Kriteri I perzgjedhjes perfshin tre fusha: Moshja (deri ne 39 vjec ka priritet te larte); mbi 40 vjec, me pak priritet), gjinia, (grate kane perparesi ndaj burrave), dhe eksperienca ne mesimdhenie, duke perfshire te dhena ne lidhje me faktin se sa jane ne gjendje mesuesit te kuptojne zhvillimin e femijes. Sipas sindikates, ne kontrate shenoheshin vetem kerkesat dhe pergjegjesite e mesuesve,por nuk shenoheshin pergjejesite e punedhenesve. Kontaratat duhet te ishin ne fuqi deri ne fund te 2000, sipas rregulloreve te Kombeve te Bashkuara.

Duket qarte se qellimi eshte permiresimi i cilesise se stafit pedagogjik ne Kosove. Megjithate largimi i mesueve te pakualifikuar nuk kaloi pa dhimbje; shume mesues kishin punuar per vite te tera pa pagese, dhe me vone per nje page fare te vogel; largimi i tyre nga puna mund te shkaktoje tension, vecanerisht, largimi i mesuesve dhe administratoreve. Megjithate me kthimin e shume kosovareve ne atdhe, dhe me tendencen demografike, duhet te kete shume mundesi te reja pune dhe per mesues te kualifikuar.

Ne te njejten kohe, permiresimi i punes ne sektorin arsimor, kerkon disa ndryshime te dhimbshme, pershembull ne Kosove mesuesit japin vetem nje lende; nese mesuesit do te ishin ne gjendje te jepnin mesim ne fizike, kimi dhe biologji (shkence) do te nevojiteshin me pak mesues, dhe pagat e tyre do te ishin per rrjedhoje me te larta. Eshte e nevojshme te formohet nje sistem monitorimi I besueshem, qe te te gjeje tregues, qe e justifikojne shpenzimet ne fushen arsimore, per te gjitha nivelet. Tani per tani nuk ekziston nje sistem I tille ne Kosove.

Pergatitja e Mesuesve

Vezhguesit thone se procesi i mesimdhenies dhe i te mesuarit ne Kosove eshte shume tradicional. Nje zedhenes nga Universiteti i Prishtines (Departamenti i Trajnimit te Mesuesve) tha se ne shkollen elementare, metodat pedagogjike dhe arsimore, ngadonjehere jane “mizore”, dhe nuk i nxisin femijet per te mesuar. Ashtu si ne shume vende te tjera fqinje, curriculat jane te mbingarkuara me “fakte”, dhe vihet pak theks ne te kuptuarit e koncepteve dhe problemeve. Gjithashtu nxenesit nuk zhvillojne dot aftesite e te menduarit. Per shkak te eksperiences se kaluar politike dhe shoqerore, shume mesuesve u mungon trajnimi, dhe per kete arsye nuk jane kompentente per te krijuar ambient te favorshem dhe produktiv per mesimin.

Mesuesit jane pergatitur ne 8 Institute dhe Fakultete te vecanta. Tabela 4 tregon llojet e instituteve pergatitore. Ne SFRY mesuesit e arsimit fillor (klasa 1 deri ne 4), kane mbaruar ose shkollat e larta pedagogjike(4 vjet studim), ose jane diplomuar nga universitetet (pas 4-5 vjet).

Mesuesit e shkollave te mesme jane pergatitur dhe akoma pergatiten gjate nje periudhe 4-5 vjecare ne universitet. Tani pergatitja e mesuesve ne universitet, eshte e koordinuar me Universiteti e Prishtines. Mesimet zhvillohen vetem ne gjuhen shqipe; nuk ka institut qe pergatit mesues ne gjuhen serbe.

Pergatitja eshte teper akademike, dhe e ngarkuar me lende, me perjashtim te kursit te pedagogjise qe zhvillohet ne Fakultetin e Filozofise. Kocepti “mesimdhenia si profesion” mungon ne curricul. Bile dhe disa nga lendet qe kane lidhje me kete fushe, jepen ne nje nivel teper akademik. Praktika mesimdhenese ne shkolla, ose metodat e mesimdhenies, zbatohen pa objektiva ose synime te qarta. Universiteti nuk ka nje vizion te qarte, as nje politike afatgjate, per planifikimin strategjike aftashkurter ose afatmesem, per pergatitjen e mesuesve ne shkolle, dhe kur ata jane duke ushtruar profesionin e tyre si mesues.

Mendohet qe pergatitja e mesuesve te behet nen nje ombrelle institucionale. Institucioni kryesor qe eshte Universiteti i Prishtines, synon te hape nje Fakultet te ri, Fakulteti i Arsimit. Qendra te ndryshme trajnimi per mesuesit do te jene filiale te ketij fakulteti, pra pjese e universitetit. Nje nga veshtiresite kryesore ne kete reforme eshte mungesa e njohurive dhe aftesive te specialisteve qe pergatisin mesues. Shume prej tyre jane shkeputur krejtesisht, dhe nuk zoterojne informacion lidhur me pergatitjen e mesuesve ne plan kombetar; puna e tyre bazohet kryesisht ne traditen mesimore te SFRY ne vitet ‘70-‘80.

Pergatitja e mesuesve ne shkolle, behet ne nivel bashkiak dhe rajonal. Nuk ka te dhena te nje analize per nevojat qe mund te kene mesuesit dhe per planifikimin afatshkurter apo afatmesem ne pergatitjen e mesuesve. Aktivitetet mesimore per pergatitjen e mesuesve zhvillohen kryesisht nga OJQ-te ose Agjensi Drejtuese, sepse Drejtorite Rajonale dhe Bashkiake, ose Universiteti nuk kane specialist profesionist per pergatitjen e mesuesve. Pergatitja e stafit ne shkollle ndodh rralle, dhe cilesia le per te dyshuar. Kjo pergatitje reflekton ne shume raste metodologjine dhe qendrimet e instituit pedagogjik te dikurshem. Curriculumi i pergatitjes se mesuesve ka natyre akademike, eshte i vjeteruar dhe mesuesit nuk perfshihen ne planifikim dhe zbatim te njohurive gjate pergatitjes.

Pergatitja e mesuesve eshte ne nje fare mase ne duart e komunitetit nderkombetare. Per shembull, Fondacioni per Shoqeri te Hapur ne Kosove (KFOS) ka nxjerre Forumin e Kosoves, i cili zhvilloi nje workshop, mbi Menaxhimin e Ndryshimeve ne Arsim, i cili u mbajt ne Maqedoni, ku morren pjese rreth 40 Kosovare. Keshilli Britanik ka organizuar disa sesione trajnimi ne gjuhen angleze, ne te gjitha Kosoven. Po keshtu, Byroja e Lidhje me Francen ka zhvilluar programe trajnimi per mesuesit ne gjuhen frenge. Megjithate mungon nje strategji e plote per pergatitjen e mesuesve. Per me teper, nuk zhvillohet trajnim ku te diskutohen ceshtjet dhe problemet qe kane lindur pas konfliktit. Gjithashtu, nuk pergatiten mesuesit per te mesuar femijet qe paraqesin nevoja te vecanta.

Tabela 4 Institutet per Pergatitjen e Mesuesve, Shtator 2000

Tipi i Institutit	Vendi	Niveli
Fakulteti I Filozofise	Universiteti Prishtines	1-4 dhe Pedagoge
Fakulteti I Sociologjise dhe Filologjise	Universiteti Prishtines	9-12
Fakulteti I Shkencave	Universiteti Prishtines	5-8 dhe 9-12
Fakulteti I Mesuesise	Universiteti Prishtines	1-4/5
Shkolla e Mesme/ Kolegji I Mesuesve	Gjilan	Parafillore
	Prishtina	1-4/5 dhe 5-8
	Gjakova	5-8

Burimi: Departamenti I Arsimit dhe Shkences

Pergatitja e mesuesve eshte nje prioritet per UNMIK dhe per partneret e tij. Eshte e qarte nga vizitat e bera ne komunitete dhe shkolla, se shumica e mesuesve Kosovare, kane nevoje per mbeshtetje urgjente per te rritur aftesite e tyre profesionale ne nivelin e kompetences sa me adekuate. Akoma nuk ekziston nje strategji ose veprim i koordinuar i donatoreve; fusha e pergatitjes se mesuesve duket si e copezuar dhe e mbingarkuar, dhe mesuesit nuk jane ne gjendje te trajtojne problemet e shumta per sa i perket aftesise se tyre. Nenkujdesin e Agjensise Drejtuese (Agjensia Kanadeze per Zhvillim Nderkombetare (CIDA) dhe te eksperteve te saj, shume specialiste jane atashuar me DES per te udhehequr punen ne fushen e pergatitjes se mesuesve.

Ceshtje dhe Pengesa ne Personelin Arsimor

- *Kushte te keqia pune.* Mesuesit ne Kosove punojne ne kushte te keqia fizike dhe materiale, shume ndertesa shkollash kane mbeyur te demtuara per shkak te bombardimeve dhe sulme te tjera nga grupe te ndryshme njerzish. Materialet mesimore jane te kufizuara ne numur, dhe cilesia e tyre nuk siguron mesimdhenie dhe mesim te mire. Shume shkolla punojne me me shume se nje turn; shkollat jane te mbingarkuara me nxenes dhe nuk ka hapësira te lira per asnje veprimateri tjetër përveç se mesimit të rregullt që zhvillohet në klasa. Refugjatet që janë kthyer e shtojnë këto mbingarkese sepse studentet ndajnë me ta bankat dhe materialet e mesimit.
- *Pagat e mesuesve kane qene shume te ulta, dhe mbeten relativisht te ulta, edhe sipas skemes se re te pagave.* Mesuesit vazhdimisht duhet te kerkojne te ardhura shtese gje qe ndikon negativisht ne aftesine per tu perqendruar ne procesin mesimor. Ne disa lende (gjuhe te huaja, matematike dhe shkence) ka mungese mesuesish sepse shume nga ata marrin paga me te larta duke punuar per agjensite nderkombetare. Pamvaresisht nga kjo morali i mesuesve mbetet relativisht i mire, dhe njerezit e vleresojne shume arsimin dhe personelin mesimdhenies.
- *Mungese e strategjive dhe kriterëve te qarta per cilesi ne arsim.* Nje nga tiparet e perbashketa ne shume sisteme tranzicioni eshte “reforma pa vizion”; dhe arsimi ne Kosove nuk ben perjashtim. Te menduarit e ri eshte nje proces qe sapo ka filluar dhe ne nje fare mase nxitet nga idera dhe eksperienca e komunitetit nderkombetare. Mbetet sfide e madhe krijimi i nje strategjie vendase e cila te mund te drejtonte reformen ne nivel operativ. Per sa i perket cilesise nuk ka nje koncept te perbashket se cfare mund te quhet arsim i “mire”. Me cilesi kuptohen masat sasijore dhe jo rezultatet. Kjo pikpamje e ngushte per cilesine eshte nje pengese e madhe per te ndryshuar mesimdhenien, mesimin dhe vleresimin ne vecanti.
- *Konsekuencat e konfliktit dhe femijet me nevoja te vecanta.* Shume femije kane vuajtur direkt ose indirekt nga tmerret e luftes dhe konfliktit te fundit. Familjet Kosovare shpesh kane shume femije dhe nje tradite te forte te nje “familje te madhe”; kjo do te thote qe shume ngjarje traumatike qe ndodhen ne shume familje u pane ne sy nga nje numur antaresh te se njetes familje. Nuk eshte qellimi i ketij raporti te hyjme ne hollesi te ketyre ngjarjeve te dhimbshme te shume individeve; eshte e qarte se ato kane lene plage te renda ne zemrat dhe shpirtrat e shume femijve, dhe keto kujtime mund ti ndjekin ata gjate gjithë jetes se tyre. Sistemi shkollor ne teresi, dhe mesuesit ne vecanti, po perpiqen qe te trajtojne kete problem te ri me qe shume studente jane

duke u kthyer ne klasa. Shumica e mesuesve nuk i kane mjetet e nevojshme dhe njohurite konceptuale per ti ndihmuar femijet qe ta ndejne veten te sigurte, mesuesit e kane te veshtire te merren me kujtimet dhe emocionet e tyre dhe te punojne pasi jane kaluar kaq shume eksperience traumatike. Per me teper, mungojne dhe mesues te specializuar per te identifikuar nevojat e vecanta te femijve dhe per te gjetur menyra se si te fusin ne rrjedhen e duhur procesin e mesimdhenies.

- *Kalim nga shperndarje e informacionit drejt konceptit “te kuptosh dhe te jesh ne gjendje te besh”.* Kalimi universal i mesimdhenies eshte nje largim nga menyra e prezantimit te problemit qe dominon tashme drejt ndertimit te njohurive dhe te kuptuarit permes eksperiencave. Kjo ka qene nje sfide e madhe edhe per vete sistemin arsimor te OECD i cili ka burime te medha njerezore dhe financiare. Nje sistem i varfer me burime, i dale nga nje e kaluar socialiste e komanduar, me tradita te ngurta dhe autoritare, e sheh kete levizje si nje proces akoma me te veshtire. Kjo mbetet nje ceshtje e rendesishme, sepse Kosova nuk e ka akoma infrastrukturen, teknologjine dhe burimet per te arritur ne ndryshime; as komuniteti nderkombetare dhe financimi i donatoreve nuk mund ta zgjidhe kete problem. Zgjidhja kerkon nje perkufizim te ri te qellimit qe duhet shkolla ne Kosove; zhvendosja e vemendjes nga formimi i nje fuqie punetore per tregun vendas dhe te huaj, drejt edukimit te te gjithe individeve me shume njohuri aftesi dhe qendrime te reja.

Arsimi i Femijeve Parashkollor

Para krizes se viteve 1998-1999, shteti siguroi sherbime para dhe pas lindjes per femijet nga mosha 0-3 vjec. Megjithate, ne krahine nuk kishte ndonje tradite per kujdesin e femijeve bazuar ne institucione dhe sherbimet ishin per kujdesin ndaj femijeve dhe jo per natyren edukative ku ne qender ishte femija. Nuk ekzistonin qellime te qarta per kujdesin parashkollor dhe nuk kishte programe per te ndihmuar prinderit ne shtepi. Ekzistonin vetem disa programe te organizuara nga qendrat e kopshteve te femijve. Femijet me paaftesi dergoheshin ne institucione te specializuara, dhe rralle mbaheshin nen te njejtin kujdes gjate gjithe kohes. Pergatitja e mesuesve ne shkollat per te trajtuar ceshtjet e femijerise se hereshme, ose behej ne shkollat pergatitore te mesme te cilat kishin nje program 2-vjecare per pergatitjen e mesuesve ne nivel elementare, ose nje program universitar 4 vjet per pergatitjen e mesuesve per shkollat e mesme. Por asnjera prej ketyre metodave nuk kishte ne qender femijen. Nuk ekzistonte trajnimi i mesuesve ne pune e siper, pra nuk behej ndonje kurs stazhi pergatitor.

Ne Bosnje dhe Herzegovine u bene disa perpjekje per te futur modele te reja pedagogjike. Fondacioni SOROS filloi programin “step by step” ne Kosove ne 1997, duke siguruar materiale dhe kurse trajnimi ne 2 shkolla parafillore, dhe ne 8 shkolla fillore. Ky program eshte nje pakete e trajnimit te mesuesve qe permban materiale dhe mbeshtetje financiare per sherbime ndaj femijve qe nga 9 muajsh deri ne 6 vjec. Programi ka per qellim te fuse metoda te reja me ku ne qender te jete femija dhe perfshirja e prinderve dhe ky program tashme eshte shtrire dhe eshte bere nje faktor i madh ndryshimi. Gjate luftes, keto sherbime u kryen nga OJQ-te ku kujdesi per femijen behej ne shtepi. Ne fund te Qershor 1999 nje raport qe u hartua, tregoi se sa demtim fizik kishte pesuar sistemi shkollor. Jo vetem infrastruktura por dhe ai sistem i dobet i sherbimeve, kujdesi per bebet paralindjes, te gjitha ishin zhdukur.

Pas lufte donatore te fuqishem si UNICEF se bashku me refugjatet e kthyer, filluan rindertimin e sistemit shkollor duke filluar qe nga rikonstruksioni i godinave te shkollave, dhe ngritja e shkollave cadra, arriten shume sukses ne fillimin serisht te sistemit shkollor per femijet 7 deri ne 14 vjec. Ndjehen permiresime ne pedagogji, te cilat bazohen permes programeve pilot, duke perfshire edhe ato me metoda ndervepruese per mesimdhenien,

organizim i workshop-eve per pergatitjen e mesuesve, mbeshtetje psiko-sociale per mesues dhe femije, qe demonstroi shenja traume dhe shqetesime te tjera, si dhe arsimi per femije ne komunitete minoritare. Shumica e femijve u kthyen ne shkolle, nga Gusht i 1999. Megjithate ka nje terheqje graduale te kontributeve te donatoreve per arsimin parashkollor, por megjithate mund te themi dhe se ky problem po i kthehet normalitetit.

Programet parashkollore filluan ne 1999. UNICEF ndihmoi per grumbullim informacioni lidhur me materialet parashkollore dhe furnizimin e 24 nga 44 institucione parashkollore ne Kosove. Gjithashtu ka dhe 3 qendra model per trajnimin parashkollor. Aktivitetet e tyre perfshijne mbeshtetje per 102 klasa per femije nga lindja deri ne moshen 6 vjec, ne 24 parashkolla, pervec 25 klasave per femije 6-vjecare, ne 25 shkolla, ku jane 1200 femije, (duke perfshire nje klase ne gjuhen turke per femije turq, dhe 5 klasa per romet) . Pergatiten 356 mesues dhe 40 drejtues fakultetesh dhe 60 drejtues per institucionet parashkollore. Sistemi parashkollor paguhet me honorare qe varrojne nga 30-60 DM ne muaj. UNICEF ka ngritur 56 ambiente lojrash per femije ne zonat me te varfra rurale, ka jane trajnuar 300 persona te stafit mesimor per te punuar me femijet e vegjel, ka ngritur cakra, dhe ka furnizuar qendra me lodra dhe mjete argetimi per femije. Keto perpjekje fillestare duhen ruajtur dhe vazhduar me tej.

Kopshtet e femijve jane te ndara nga problemet etnike dhe drejtohen nga grupe serbe te cilet perdorin modele te kopshteve parashkollore te trasheguara nga Jugosllavia. Keshtu ka klasa te vecanta per femijet 6-vjecare me qellim qe ata te ndihmohen per te hyre me vone ne shkolle, (shkollat serbe nuk kane adoptuar akoma uljen e moshes shkollore ne 6 vjec, ashtu sic u dekretua nga UNMIK ne Shtator 2000). Per grupin e femijve nga 9 muaj deri ne 3 vjec, mungojne te dhenat lidhur me ceshtjet sociale qe ndikojne ne zhvillimin e femijes. Numri i familjeve me nje prind eshte 19.800, dhe nuk ka familje ku kryetare te jete nje femer, dhe as nuk tregohet numri i grave qe punojne si para lufte dhe pas lufte. Ne periudhen paralufte, vdekshmeria e femijve ishte 21,6%, dhe ne Qershor 2000 Organizata Boterore e Shendetesise WHO, vleresonte se vdekshmeria para lindjes ishte midis 30-40%. Megjithese sherbimi shendetesor per nenat dhe femijet eshte falas, ndoshta cilesia e ulet per kujdesin e femijes, shton semundjet e femijve, (per shembull, femije te shurdher per shkak te mungeses se trajtimit me antibiotik, te cilet kerkojne mbeshtetje arsimore. Niveli i ushqimit eshte duke u permiresuar, por ka disa shenja paralajmeruese, qe te kequshqyerit e paralufte mund te kthehen perseri. Numri i femijve te kequshqyer duket se ka rene, por praktikat e ushqimit te femijve dhe dietat per nenat jane ende te varfra (ka nena me shendet te tepert, obese, dhe nena qe kane shume barra) dhe keto mund te rrezikojne zhvillimin e hershem te femijes. Keto tregues flasin per nevojën e nje vemendje te vecante qe i duhet kushtuar viteve te hereshme te femijerise, duke krijuar programe zhvillimi per femijet.

Veprimet e Ndermarra nga Qeveria per Arsimin Parashkollor

Procesi DESK i filluar nga UNMIK, permblidhte disa rekomandime. **Se pari**, ky proces zhvilloi nje mandat per arsimin parashkollor per secilin nivel. “Arsimi parashkollor duhet te nxise zhvillimin e aftesive, kapacitetit te femijes, duke zhvilluar interesat e tij, plotesimin e nevojave, zhvillimin e aftesive me qellim qe femija te jete I pergatitur per t’ju pergjigjur nevojave te se ardhmes qe paraqet jeta, familja dhe shoqeria”. Inisiativa e DESK vlersoi si prioritet imediat, perfshirjen me te madhe te femijve ne parashkolla me pjesemarrje te detyruar qe nga moshja 5 vjec. Qellimi ishte te sigurohej frekuentimi 100% i femijve nga moshja 3-5 vjec, dhe ky frekuentim te behej i detyruar dhe te krijoheshin kushte me te mira per femijet nga 9 muaj deri ne 3 vjec.

DESK gjithashtu rekomandoi ndryshime ne fushen administrative ku te reflektehej rëndesia e madhe e viteve te para te femijerise, duke perfshire nje seksion te vecante per arsimin parashkollor brenda ministrise, dhe ne seksionet pedagogjike, dhe ne seksionin e pergatitjes se teksteve shkollore. Gjithashtu, DESK rekomandoi nje ndarje sipas nivelit bashkiak, duke e vendosur arsimin parashkollor ne barazi me te gjitha nivelet e tjera arsimore, dhe duke zgjeruar keshillin e prinderve me tej. Me interes te vecante eshte rekomandimi per te vendosur nje grup ndersektorial per progarmet e arsimit parashkollor.

Qysh ne Shtator te vitit 2000, moshja e hyrjes ne shkolle u vendos 6 vjec. Kjo ka krijuar pak konfuzion ne zhvillimin e klasave te para, vecanerisht ne shkolla qe jane te mbingarkuar me nxenes dhe qe operojne me shume turne.

Ceshtje dhe Pengesa ne Arsimin e Hershem Parashkollor

Kujdesi parashkollor dhe arsimit ne Kosove eshte shume i dobet. Ndjehet nevoja e ndryshimeve te rëndesishme per sa i perket sjelljes dhe kujdesit te prinderve, komuniteteve, dhe sistemit te shkolles per te permiresuar edukimin ne kete faze vendimtare ne jeten e femijes. Sherbimet qe ju behen femijve te vegjel nuk jane te mjaftueshme dhe nuk kuptohet mire nevoja per programe lidhur me zhvillimin e femijes. Per shembull, ne Shqiperi 37 % e femijeve frekuentojne institucionet parashkollore, cerdhe dhe kopshte. Ne Maqedoni 20 %, ndersa ne Kosove vetem 2,8 % e femijve shkojne ne cerdhe dhe kopshte. Pervec kesaj, kjo krahasim ka ritmin me te larte te lindjeve, dhe vdekshmerine me te larte te femijve ne Europen Juglindore. Urbanizimi i shpejt qe ka sjelle shperberjen e familjeve te medha, ku me shume nene punojne, dhe ka akoma kushte te varfra jetese, duke perfshire dhe ujin e pijshem te ndotur, te gjitha keto kontribojne ne renien e shendetit te nenave dhe femijve.

Rregjistrimet jane te ulta, sepse sistemi parashkollor nuk eshte i detyruar, problemet nuk kuptohen mire, kriteret e rregjistrimit jane arbitrare dhe ngadonjehere diskriminuese, nuk ka shume vende, dhe pagesat per cerdhe dhe kopshte jane te larta. Pagat qe ju jepen mesuesve nuk jane sipas aftesive, dhe nuk jane te koordinuara mire. Curriculat nuk jane te pershtateshme dhe fleksibel, dhe mesuesit nuk kane kualifikimin e duhur. Vazhdimesia midis sistemit parashkollor dhe shkolles fillore nuk ekziston, komunitetet dhe prindrit nuk perfshihen ne ndihmesen e tyre per arsimin parashkollor.

Arsimi Profesional dhe Trajnimi

Ne kohen qe u be ky studim ekzistonin 48 shkolla te mesme teknike dhe profesionale me 46.344 studente dhe personel mesimor 3.106. Perhapja e ketyre shkollave, eshte bere ne menyre te ballancuar ne te gjithe krahasimet. Rreth 58% e shkollave jane grumbulluar rreth zonave te medha urbane, Prishtin, Prizren Peje, Mitrovoce, Gjilan, Ferizaj dhe Gjakove) me 52% staf mesimor dhe 52 % studente. Pjesa tjeter e shkollave eshte e perqendruar ne zonat rurale. Ne grupin e shkollave profesionale, 16 jane shkolla te pergjithshme teknike, 10 jane cilesuar si shkolla ekonomike, 7 si shkolla mjeksore, 3 si shkolla bujqesore, etj. Ka gjithashtu dhe nje shkolle te vogel "arti" dhe nje shkolle mesatare "gjuhe te huaja". Shkollat ofrojne arsim te perzjere profesional dhe gjimnaze (akademike); keto 6 shkolla ndodhen jashte qendrave te medha urbane, dhe kane nje staf 627 persona (20% te mesuesve te shkollave profesionale). Sistemi shkollor profesional ne Kosove reflekton direkt sistemin e dikurshem Jugosllav. Keto shkolla profesionale perfshijne dhe praktike deri ne 3 vjet, dhe disa gjimnaze ofrojne lende te perzjera, te arsimit te pergjithshem dhe te arsimit profesional. Arsimi profesional varet kryesisht nga kerkesat dhe ishte me orientim me shume teorik se sa bazuar ne kompetence.

Administrimi

Pergjegjesine per arsimin profesional e ka UNMIK/DES. Deri kohet e fundit, ne arsimin profesional punonte nje ekspert i administrates se rajonit te drejtuar nga gjermane. Per shkak te prioriteteve te tjera te DES, u kufizua kontributi i ketj eksperti per reformen ne fushen e arsimit profesional. Ne nivel rajonal 11 punonjes arsimor mbulojne arsimin profesional ne zonat e tyre gjeografike.

Brenda Departamentit te Punes se UNMIK eshte nje nepunes qe pergjigjet per pergatitjen profesionale. Nuk ka shkembim te rregullt informacioni ose planifikim te perbashket midis Departamentit te punes dhe arsimit. Kjo ka ndodhur per shkak se eshte larguar stafi i rekrutuar per nje kohe te shkurter sipas kontratave 6 mujore. Megjithate jane bere perpjekje per te siguruar bashkepunimin midis departamenteve, dhe per te vendosur nje procedure menaxhimi ne menyre qe teknologjia e dhene nga nje person i meparshem ti kalohet te gjitha departamenteve per shfrytezim.

Duhet menduar ngritja e nje mekanizmi per te shkembyer njohuri dhe per te grumbulluar informacion. Kjo mund te jete e dobishme vecanerisht vetem ne raste kur trajtohen ceshtje te perbashketa per te gjitha mesuesit dhe instruktoret dhe kur diktohet reforma ne curriculum per te lidhur arsimin profesional me arsimin e pergjithshem. Inisiativa e Agjensise Drejtuese per pergatitjen profesionale propozuar nga departamenti i arsimit, UNMIK mund te lehtesonte menaxhimin e ktij sherbimi.

Bashkepunimi '26 midis kollonave brenda administrates UNMIK do te jete shume I rendessishem nese departamenti i rindertimit ne Kollonen 4 (Zhvillimi Ekonomik) nese ky departament te zhvilloje arsim dhe pergatise specialiste qe do te sherbejne si pike kontakti midis shkollave profesionale dhe ndermarjeve.

Kushtet Materiale

Shkeputja 10 vjecare nga zhvillimet ne ish-Jugosllavi dhe mungesa e investimit te kapitalit, ka shkaktuar mbylljen e sistemit profesional ne Kosove. Perverc gjendjes se keqe materiale ne shkollla, punishtet ku behet praktika profesionale nuk plotesojne standartet minimale. Materialet e punes ne shkollat profesionale reflektojne curriculumin e meparshem ku ne baze qendronte puna, punesimi. Materialet per studente dhe mesues jane te varfere, ato gjenden me veshtiresi, jane te pa mjaftueshme dhe nuk plotesojne as nevojat e punes ne klase dhe as ne praktike; ne punishte.

OJQ-te kane dhene ndihme per rindertimin e disa shkollave te zgjedhura per ta zgjidhur ne nje fare menyre kete problem, por perseri situata kritike per shkak te mungeses se investimeve qe nga 1998, nuk mund te riparohet menjehere. Ceshtjet shendetsore dhe siguria ne ndermarjet ekzistuese mbeten problemi kryesor; per sa i perket struktures se ndertimit, ventilimit, dhe ambienteve sanitare. Ne curriculumen nuk paraqiteshin keto probleme si themelore per mesimdhene.

Per shkak te kushteve te keqia te shkollave profesionale, perseri ka disa shembuj, pozitive te mbeshetjes qe i kane dhene disa donatore per rindertimin dhe pajisjen e punishteve. Megjithate eshte e rendesishme te theksohet se pajisjet e siguruara nga donatoret duke perfshire curriculumen shoqeruese dhe trajnimit e instruktoreve reflektojne realitetin e ambientit te punes, qe do te gjejne nxenesit pas mbarimit te shkolles. Nje repart pune i sofistikuar, qe nuk ka lidhje shume me mjetet dhe metodat qe studentet gjejne ne industri apo ndermmarje, nuk i pergatit ata per tregun e punes ne vend, Perpara se te jepin fonde per nje repart pune ne shkolle, donatoret duhet te kontrollojne mire realitetin, se ku mund ti zbatoje nxenesi aftesite dhe metodat e tij ne

26 Administrat UNMIK fillimisht u organizua ne “ kollona”, per shembull: pune humanitare/ refugjate; administrate civile, ndertim institucionesh, rindertim; secila nga keto drejtohej nga nje agjensi e ndryshme, si p.sh. UNHCR, OSCE, Bashkimi Europian, etj.

tregun lokal te punes; mesuesit dhe punedhenesit lokale duhet te jene te kujdeshem ne planifikim per te siguruar perdorim te mire te pajisjeve, per te lidhur teorine me praktiken e tregut dhe per tja pershtatur curriculen ekzistuese dhe pergatijen e mesuseve, per tja pershtatur realitetit.

Lidhjet midis Shkolles Profesionale, Ekonomise Lokale dhe Strukturave te Tregut te Punes.

Nuk ekziston fare lidhje midis shkollave profesionale dhe fushe ekonomike; kjo shkakton krejtesisht nocion te arsimit profesional. Ne nivel shkolle asnje antar i personelit mesimor nuk ka pergjegjesi per te krijuar lidhje me punedhenesit ose me organizatat partnere sociale. Gjithashtu, ka lidhje te dobta, ose nuk ekzistojne fare lidhje me tregun lokal te punes dhe strukturat e tij mbeshtetese. Shkolla nuk interesohet me per nxenesin kur ai punesohet; lidhjet me zyrat e punesimit jane shume te dobta.

Se fundi, mund te krijohej nje agjensi trajnimi ku te kombinohej arsimi profesional me arsimin e mesem ose bashkangjitur ketij te fundit, ose me lidhje direkte me zyrat e punesimit per te siguruar nje trajnim te integruar me punen. Nje kuader i tille institucional, do te zhvillonte nje politike per nje mesim gjate gjithë jetes si edhe do te mundesonte pune te metejshme kerkimore.

Cdo shkolle duhet te kete te pakten nje mesues qe te pergjigjet per lidhjet me punedhenesit lokale, dhe nje mesues tjetër per te krijuar bashkeveprim me zyren lokale te punesimit. Keta mesues duhet te pergatiten per shembull, per te komunikuar me zyrat e komunikimit, per mbledhje te dhenash, dhe per gjetjen e vendeve te punes, dhe per caktimin ne pune.

Reformat e Reja

UNMIK/DES ka ndermarre disa hapa per te trajtuar problemet qe i dalin arsimit profesional pas rregulloreve qe u nxorren nga Beogradi ne 1989. Se pari, u bene perpjekje per te filluar nje strategji dhe nje proces planifikimi brenda kuadrit te reformes arsimore te DESK’ 27. U ngrit nje grup pune per te percaktuar prioritete dhe per te bere rekomandime per reformen dhe zhvillimin e arsimit profesional. Grupi i punes nuk nxorri ndonje orientim ose rekomandim strategjik, qe nuk ishte aq shume deshtim i grupit te punes, se sa mungesa e iniciatives se DESK ku mungonte mbeshtetja lokale per kete fushe arsimit.

Nje iniciative e dyte e UNMIK/DES eshte nxjerrja e burimeve per zhvillimin e arsimit profesional qe do te ndermerrej nga nje organizate e jashtme ose Agjensi Drejtimi. Kjo eshte nje levizje e drejte, por duhet perforcuar me perfshirjen direkte te Departamentit te Punes se UNMIK, (DOLE) me organizatat e punedhenesve dhe me partnere te tjere shoqeror ne menyre qe zhvillimet ne arsimin profesional te mos shihen si te izoluara nga i gjithë sistemi i pergatitjes per pune’ 28.

27. DESK(do te thote zhvillimi i sistemit arsimor ne Kosove), Punim Seksioni I Arsimit UNMIK, 17 Tetor 199.
28. Qe nga vizita e grupit te OECD, ka filluar bashkepunimi midis DES dhe DOLE me inisiativen e Agjensise Drejtuese dhe zyres se punesimit ne Kosove.

Pergatitja e mesuesve per arsimin profesional dhe curriculumin do te jene detyrat kryesore te Agjensise Drejtuese krahas pergatitjes se kuadrit ligjor, standarteve, formulimit dhe dhenies se certifikatave partnershipit social dhe lidhjen me punen ne plan nderkombetare. Eshte e rendesishme qe reforma dhe planet e zhvillimit per trajnimin e mesuesve dhe zhvillimin e curricules te koordinohen me nje agjensi te vecante (te mbeshtetura nga fonde Kanadeze), te cilat do te trajtojne probleme te trajnimit te mesuesve ne vecanti. Aftesite qe nevojiten per zhvillimin e industrise dhe ndermarrjeve jane universale ose kane shume elemente te perbashket. Perdorimi i paketave te trajnimit nga vende te tjera do te ule shpenzimet ne menyre te ndjeshme; keto shpenzime nuk do te jene aq te medha si per nje pune te filluar rishtas, neqoftese ato pershtaten sipas nevojave te Kosoves.

Ceshtja kryesore e dialogut do te jete perfshirja e pronareve lokale per tu siguruar qe rekomandimet e reformes do te zbatohen ne terren. Nevojiten gjithashtu dhe aksione pilot, vizita studimore dhe asistence teknike per shume fusha, ne mbeshtetje te aftesise ndertuese lokale, per te formuar politika te reformes institucionale.

Ceshtje dhe Veshtiresi ne Arsimin Profesional

- *Rekrutimi i mesuesve te arsimit profesional dhe zhvillimi i stafit.* Deri tani nuk ekziston trajnim i vecante per pergatitjen e mesuesve te profilit profesional ne Kosove. Eshte e qarte se ndihet nevoja per mesues te tille qe te kene nje pergatitje te pergjithshme si edhe pergatitje per arsimin e mesem. Ka pak kurse per pergatitjen e mesuesve, pervec disa seminareve qe organizohen nga OJQ-te dhe nga disa projekte bilaterale. Te gjitha keto perpjekje vleresohen nga personeli mesimor, megjithate ndihet nevoja per nje zhvillim sistematik te kurseve per pergatitjen e mesuesve te profilit profesional ne menyre qe te krijohet nje sistem trajnimi modern dhe efektiv.
- *Pergatitja per menaxhimin e shkolles dhe administrimin.* Menaxhimi dhe administrimi i shkollave profesionale eshte i nevojshem ne rast se duhet te ngrihet nje sistem arsimor efektiv. Drejtoret e shkollave dhe stafi drejtues duhet te pergatiten; vecanerisht ata qe u larguan nga punet e tyre drejtuese pas vitit 1989, edhe ata qe do te marrin funksione te reja drejtimi.
- *Strategjia e ndermarjes ne baze shkollen.* Nje fushe me interes te vecante per krahinen dhe me gjere per Europen, eshte pjesemarrja ne arsim si pjese e nje curriculumi me te gjere per te zhvilluar inisiativen tek te rinjte dhe per te krijuar njohuri baze te domosdoshme per punesim dhe per biznesin e vogel. Kjo fushe e ndermarrjeve duhet te shtjellohet krahas diskutimeve per reformen e curriculumit e cila do te drejtohet nga nje agjensi drejtuese per trajnimin profesional.
- *Kontributi i partnereve social per reformat ne arsimin profesional.* Partneret social ne Kosove nuk kontribojne ne arsimin profesional. Grupi i punes per arsimin profesional DESK nuk perfshinte perfaqesues nga punedhenesit, ndersa perfshirja e sindikatave ishte e kufizuar vetem ne sindikaten e mesuesve pa perfshire sindikatat ne fushen e

industrise dhe te tregetise. Keta partnere jane shume te rendesishem per nje zhvillim te sukseshem te arsimit profesional.

- *Drejtimi dhe konsulenca e mesuesve te shkollave profesionale.* Shkollat nuk sigurojne konsulence dhe udheheqje profesionale. Disa zyra punesimi te Sherbimit te Punesimit ne Kosove i ndihmojne shkollat, por te krijohet pershtypja se keto pune behen mbi baza kontaktesh personale , e jo mbi bazen e nje praktike profesionale te njohur.

Arsimi I Larte

Origjina dhe Zhvillimi

Megjithese fakultetet e para dhe institucionet e arsimit te larte ne Kosove u themeluan midis viteve 1958 dhe 1969, ato funksiononin ose ne menyre te pavaraur ose brenda Universitetit te Beogradit. Universiteti i Prishtines u themelua ne 1970 me 4 fakultete (filozofi, juridik, inxhinjeri dhe mjekesi). Ne vitin 1990 numri i fakulteteve u rrit ne 13, dhe 7 shkolla te larta u bashkuan me universitetin. Ne kete kohe, mesimi zhvillohej ne 2 gjuhe: shqip dhe serbisht. Ne Korrik 1991, Parlamenti Serb ndermorri masat famekeqe “interim” duke caktuar serbet ne te gjitha postet e larta. Brenda 6 muajsh i gjithë stafi shqiptare dhe studente u debuan ose u larguan nga shkolla. Asambleja e Universitetit votoi per te vazhduar punen ne ambiente private dhe kjo asamble zgjodhi rektorin e Universitetit. Per 8 vitet qe vijuan, puna vazhdoi ne “ hije”, ose sistem paralel, i cili u zhvillua ne kushte shume te veshtira. Ne Qershor 1998, dy godina ju kthyen Universitetit dhe nje godine e trete ju dha ne 1999; keto godina ishin demtuar rende dhe ishte shkateruar me qellim te gjitha pajisjet dhe mjetet qe ato dispononin.

Tani ne vitin 2001, Universiteti i Prishtines ka 14 fakultete dhe 7 shkolla’29 te larta. Ka plane per te ngritur disa nen njesi shtese si per shembull, Instituti i Psikologjise, Departamenti i Shkencave Politike dhe Administrates Publike, nje shkolle per Gazetari ku do te merret nje grade shkencore Master. Departamenti i fizioterapise, dhe nje Departament per Ujin dhe Higjenizimin (Inxhinjeri Civile).

Universiteti gjithnje eshte konsideruar nje pike e rendesishme per intelektualet etnike shqiptare ne krahine dhe ka lidhje te mira me universitetet ne Zagreb, Tirane dhe Tetove ’30. Shoqata e Universiteteve Europiane (qe me pare eshte njohur si CRE), ne bashkepunim me Keshillin e Europes ka nje grup pune te vecante ne Prishtine i cili mbeshtetet nga Sherbimi i Universitetit Boteror (WUS- Austria), permes te cilit kanalizohet mbeshtetje nga Komuniteti Akademik European. Universiteti ka nje fare autonomie e cila e lejon qe te mbaje te distancohet ne nje fare menyre nga politika e perditeshme. Pjesa me e madhe e personelit mesimor dhe e studenteve jane kosovare.

Sipas statutit te universitetit, qellimi i ketij institucioni eshte “ te jape arsim te larte dhe krijoje mundesi per pune kerkimore shkencore; te krijoje, te mbroje dhe te transmetoje njohuri permes mesimdhenies dhe punes shkencore” .

Rregulla Akamedike

Ne Universitetin e Prishtines mesimet zhvillohen ne gjuhen shqip, por ligjerisht mesimi mund te zhvillohet dhe ne gjuhe te tjera, (per shembull turqisht), dhe ne departamentin e gjuheve te huaja mesimi zhvillohet ne gjuhët perkatese.

Viti akademik fillon ne 1 Tetor deri ne 30 Shtator; ka dy semestra me 30 jave mesimore ne vit; sesioni i provimeve zhvillohet ne Janar, Qershor dhe Shtator; shkollat e larta mund te kene dhe sesione provimi shtese, ne Tetor dhe Prill.

29. Ne Universitetin e Prishtines ndodhet Fakulteti I Mesusise, dhe 4 nga Shkollat e Larta jane: Shkollat e Larta Pedagogjike (ne Prishtine, Prizren Gjilan dhe Gjakove)
30. Ky Universitet nuk ekziston zyrtarisht dhe nuk njihet ne Republiken e Maqedonise.

Universiteti ofron 4 tipe studimi: Kurs Universitare (minimale 4 vjet), kurs shkencor pasuniversitare; kurs profesional pasuniversitare; dhe kurs artistik pasuniversitare (disa nga shkollat e larta brenda universitetit ofrojne kurse 2 ose 3 vjecare). Ne Statut permendet nje sistem krediti, por ky nuk do te zbatohet deri ne vitin 2001-2002. Ky sistem nuk eshte i qarte dhe nuk eshte i zbatueshem. Curriculat propozohen nga fakultetet ose shkollat, aprovohen nga senati, dhe rishikohen cdo vit. Planifikimi i curricules nuk eshte i organizuar mire. Programet per marrjen e gradave shkencore, jane duke u rishikuar sipas Deklarates se Bolonjes, modeli 3-5-8, eshte aprovuar nga senati, Studentet lejohen te ndjekin kurse ne disa institucione ne te njejten kohe, por njohja e provimeve vendoset nga komisionet e ngritura ne cdo fakultet. Ne nivel universitar, nuk ekziston koordinim pune per njohjen e ketyre provime.

Ne Universitetin e Prishtines, praktikisht nuk ka studime per doktorature ose grada profesionale. Megjithate shume studente pas perfundimit te universitetit vazhdojne dhe 4 vjet te tjera per te marre graden Mjeshter i Shkences, ose Mjeshter i Arteve, pastaj eshte e mundur qe kjo grade shkencore ne doktorature, neqoftese kandidati ka botuar te pakten nje punim ne nje reviste nderkombetare dhe neqoftese eshte dakort dhe universiteti per kete gje. Kjo procedure pritet te ndryshoje se shpejti dhe te behet me rigoroze.

Profesione te tilla si Mjekesi, Dentist, Farmakologji, kerkojne dhe 2 vite stazh, plus nje provim perpara se te kualifikohet plotesisht kandidati. Juristet duhet te japin dhe nje provim pasi kane kryer 2 vjet parktike, para se te kualifikohen per te punuar si prokurore dhe gjykates. Keto jane shembuj te mire qe tregojne se pergatitja ne universitet e afron me shume studentin me standartet e profesionit qe ai do te ushtroje me vone.

Ngarkesa mesimore ndryshon ne cdo fakultet, ne cdo shkolle te larte ose institut. Parimisht profesoret kane 5 ore mesimi ne jave, mesuesit me graden e pare shkencore kane 6 ore, lektoret e tjere 4 ore ne jave, dhe asistentet 10 ore ne jave. Ngadonjehere mesuesit caktohen qe te japin mesim ne nje kurs te vecante, pamvaresisht nga numri i oreve ne jave. Kohet e fundit UNMIK ka nxjerre nje udhezim ku parashtrohet ngarkesa mesimore. Asnje antar i stafit mesimor qe punon me kohe te plote nuk lejohet te beje pune tjeter pervec punes ne universitet, duke perfshire ketu pune per shoqerite private, ose publike, ose organizatat e ndryshme, ose pune ne nje universitet tjeter, ose pune ne nje institucion te larte brenda ose jashte Kosoves, pa marre leje nga Bordi i Universitetit. Kur Bordi jep leje, ai mund te shenoje te gjitha kushtet qe i mendon te nevojshme.

Mesimi ne Universitet zhvillohet ne nje gjuhe, ne shqip. Megjithese per arsimin e larte problemi i gjuhes serbe akoma ekziston. Disa fakultete qe zhvillojne mesim ne gjuhen serbe, ndodhen ne pjesen veriore te Mitrovices, qe eshte nenmbikqyrjen e UNMIK; per arsye siguriye atje nuk ka studente qe flasin shqip, megjithese ka studente nga minoritetet e tjera. Ekzistojne dhe disa projekte te vogla per studente qe flasin serbisht.

Tekstet mesimore dhe materiali mesimor pergatiten nga mesuesit qe zhvillojne kurset. Propozimet per hartime tekstesh i paraqiten Keshillit Botues te Universitetit dhe nese

konsiderohet si propozim i vlefshem nga 2 referues, atehere ai perfshihet ne planin vjetor te botimeve. Autoret duhet te marrin honorare, por ata rralle paguhen; autoret shpesh i shesin librat e tyre dhe grumbullojne te ardhurat ne kete mneyre. Autoret botojne dhe shesin leksionet e tyre (pa autorizim). Librat e botura ne Shqiperi perdoren shpesh, ceshtjet per te drejtat e pasurise intelektuale jane te rendesishme ne shume vende te OECD, dhe keto ceshtje me siguri do te mbeten dhe ceshtje te Kosoves. Ne Kosove nuk ka institucione private per arsimin e larte, megjithese arsimi privat lejohet sipas disa dekreteve te leshuara per keta sektore. Ne Universitetin e Prishtines ekziston dhe Fakulteti i Studimeve Islamike, por ky fakultet nuk konsiderohet pjese e universitetit.

Administrata

Sistemi i arsimit te larte administrohet ne 3 nivele: Kosove, Universitet, dhe Fakultet ose nivel shkolle. Ne nivelin e Kosoves dekreti lidhur me arsimin e larte kerkon nje keshill kombetare te arsimit te larte, por ky keshill nuk eshte ngritur asnjehere.

Sipas projekt statutit Interim te Universitetit '31, organizatat kryesore te Universitetit jane : Bordi dhe Senati, te dyja ushtrojne funksionet e tyre sipas parimit te votes mazhoritare. Bordi ka te drejte te vendosi dhe Organizma te tjere, Komitete dhe Komisione me detyra te vecanta. Cdo nen njesi (per shembull, fakulteti, shkolla e larte ose instituti eshte pjese integrale e universitetit dhe asnje organizem tjetër nuk mund te kete formen e nje ligjevenesi te pavarur. Figura kryesore akademike dhe administrative e univerisitetit eshte Rektori, i cili pergjigjet per gjithë mbarevajtjen e universitetit. Rektori zgjidhet nga Bordi, nga profesoret e universitetit te caktuar nga Senati. Detyra eshte 4 vjecare me te drejte rizgjidhje dhe per nje mandat te dyte.

Ne nivel fakulteti dhe ne nivelin e shkolles se larte, organi drejtues eshte Keshilli i Fakultetit dhe Keshilli i Shkolles se Larte. Autoriteti kryesor ekzekutiv eshte Dekani ose Drejtori (kjo varet nga lloji i institucionit). Caktimet ne stafin administrativ, ne stafin mesimor, percaktohen sipas dekretit te vitit 1994, Statutit te Universitetit (1995), dhe statutit te riformuar te vitit 2000, rregulloreve te vecanta te senatit, dhe statutit te secilit institucion.

Caktimet ne postet mesimdhense behen permes konkurimit publik (zakonisht per 3 vjet ose 4 vjet per disa bashkepuntore dhe stafi i asistenteve). Pervec detyrave qe kane mesimdhenen, fakultetet duhet te organizojne dhe pune kerkimore dhe shkencore, duhet tu mesojne studenteve metodat kerkimore. Ne praktike, shumica e punes kerkimore kryhet me iniciativen e shkencetareve si individe, te cilet bejne pjese ne projekte qe financohen nga jashte. Fakultetet nuk duhet te paraqesin ndonje raport per aktivitetet e tyre kerkimore, as organizmave qeverisese, dhe as universitetit me perjashtim te profesoreve qe japin mesim me ore te plota te cilet duhet te paraqesin raporte te tilla cdo 5 vjet, pasi te jene zgjedhur per here te dyte ne nje post.

Financa dhe Buxheti

Deri ne vitin 1991 i tere arsimi i Larte ne Kosove finacohej direkt nga Qeveria Provinciale. Mesusit nuk ishin sherbetore civile, por paguheshin nga institucionet e tyre respektive. Studimi me kohe te plote ishte falas. Studentet me shkeputje nga shkolla, duhet te paguanin nje shume te vogel, plus nje takse per provimet.

Gjate periudhes 1991-1999 Universiteti luajti nje rol te vecante per finacimin e arsimit te Larte ne Kosove. Qeveria ne hije caktoi nje buxhet vjetor per universitetin, jo per fakultetet

ose shkollat te cilat perpiqeshin te grumbullonin fonde nga burime te tjera (duke perfshire pagesat e studenteve te cilat ishin te barabarta per te gjitha llojet e studimeve).

Gjate kohes se vizites se grupit te punes, (viti akademik 2000-2001) pothuajse i gjithe financimi per arsimin e larte duke perfshire rrogat, sherbimet materiale, u mbuluan nga Buxheti i Konsoliduar i Kosoves. Nje pjese e kesaj (afersisht 20%) vjen nga burime te brendshme, pjesa tjeter, vjen nga jashte shtetit. Nje liste cmimesh per shpenzimet e teperta (per shembull, pagesa per provimet dhe certifikatat) aprovohen nga Senati i Universitetit; kostot jane te ulta, per mesimin eshte 25 DM per cdo semester per vitin 2000-2001.

Studentet, Pranimi ne Universitet, Frekuentimi, Mesimi dhe Vleresimi

Meqenese, curricula e shkolles se mesme te hartohet me perfshirjen e mesuesve te universitetit, te pakten ne teori keto curricula jane ne perputhje te plote me kerkesat e universitetit. Ky fakt ndihmon ne planifikimin e shume studenteve qe mbaruan shkollen e mesme per te vazhduar shkollen e larte, por qe ne rastin e Kosoves, shume pak vende jane te lira ne universitet (per vitin 2000 vetem 4.545 vende ishin te lira per universitet).

Qe te konkurojne per te fituar shkollen e larte³², studentet duhet te plotesojne disa kushte: (1) duhet te kene mbaruar shkollen ne Kosove, te kene mbaruar shkollen e mesme ne vende te tjera; (2) studentet qe kane mbaruar shkollen ne vende te huaja, duhet te paraqesin nje certifikate ku te theksohet se ata kane bere te pakten 12 vjet shkolle, kane nje diplome qe i lejon ata te aplikojne per universitet, ose te marrin pjese ne provimin e pranimit, ne universitetin e atij vendi; (3) aplikantet qe paraqesin nje certifikate ne fund te studimeve nga nje institucion qe njihet ose shoqata e universiteteve Europiane, ose certifikate e akredituar nga nje agjensi kombetare qe lejon hyrjen ne universitet ose ne nje shkolle te larte. Zbatohet Konventa Per Njohjen e Kualifikimeve te Arsimit te Larte, ne Europe (Lisbone, 11.IV.1997).

Cdo fakultet ose institucion i larte ka kriteret e veta te pranimit. Ne te gjitha rastet kerkohen provimet e pranimit; kriteret e pranimit publikohen paraprakisht permes lajmerimeve nga universiteti. Lajmerimi permban numrin e vendeve per cdo fakultet, kriteret e pranimit, afatet perfundimtare per aplikim, dhe datat e provimeve.

Deri tani vetem nje kategori studentesh pranohen “ te rregullt”, megjithese dhe disa studente “ te parregullt” mund te rregjistrohen. Pranimi ne universitet eshte I bazuar ne nje kombinim te rezultateve nga shkolle e mesme te shp[rehura me sistemin epikeve, (30 % dhe rezultatet e provimit te pranimit 70%), nuk zhvillohen intervista. Studentet e sukseshem qe kane bere studime te larta ne shkolle te tjera ose jashte kaneup kane prioritet. Struktura e studimeve ne nivel universitare, eshte liberaizuar me qellimqe ti lejoje studentet te planifikojne studimet e tyre.

Studentet mund te fillojne studimet me shkeputje ose pa shkeputje nga puna, megjithese disa fakultete si mjeksia dhe inxhinjeria, pranojne vetem studente te rregulle, te shkeputur nga puna. Kerkohet qe frekuentimi te jeteiI rregullt si ne leksione ashtu dhe ne oret laboratorike dhe eksperimentale, por keto rreguilla, jane fleksibel ne praktike. Ngarkesa e studenteve eshte 20 – 30 ore ne javë (1 ore = 45 min).

Ne menyre qe te kete progres ne studimet e tyre, mbahen shenim frekuentimi i studentit dhe rezultatet e provimeve te cilat vleresohen ne fund te cdo simestri, ne fund te vitit akademik,(studentet ne vartesi te programit te tyre te studimit), japin provime qe percaktojne arrijtet e tyre per te vazhduar vitin tjeter. Konfirmohet frekuentimi i plote, dhenia e provimeve,

keto firmosen dhe vulosen ne rregjistrin e studentit, ne fund te semestrit behet liste e lendeve dhe e mesuesve qe japin keto lende.

31. Projekt rregullorja mbi statusin dhe organizimin e Universitetit te Prishtines.

Forma me e zakonshme e vleresimit eshte provimi (me shkrim ose goje). Studentet mund te japin nje provim deri ne tre here, dhe per te katerten here duhet ta japin me komision. Studentet qe mbesin en klase duhet ta rifillojne kursin nese mbesin perseri, nuk e gezojne me statusin e studentit te rregullt. Sistemi i notave eshte 1-10. 10 eshte me e larta. Por 4 notat e para nuk perdoren kurre, 5 eshte baras me mbetje., mbahen me rregull te gjithe shenimet mbi studentet. Te diplomuarit nga universiteti marrin tituj si “ ekonomistiI diplomuar, inxhinjer i diplomuar”, ose “ profesor i diplomuar”, mesues i shkolles se mesme, ndersa te diplomuarit e shkollave te larta, por pa fjalen e diplomuar, dmth, ata jane ekonomiste, inxhinjere pse profesore.

Per studentet ka pak sherbime qe ti drejtoje ata per karieren e mevonsheme, dhe ka pak sherbime keshillimi; kohet e fundit Sherbimi Universitar Boteror (WUS) ka hapur nje Qender keshillimi per studentet e cila ben pune te shkelqyer. Shumica e studenteve perpiqen te gjejne pune menjehere pas mbarimit te studimeve, ose nepermjet lajmerimeve ne gazete ose nepermjet Zyres se Punesimit. Ne disa fusha papunesia eshte e larte, te diplomuarit me veshtiresi gjejne pune, ndersa ne disa fusha te tjera, si pershembull, gjuhet e huaja, menaxhim, zakonisht ka mungesa dhe kerkohen vende pune.

Ceshtje dhe Veshtiresi ne Arsimin e Larte

- *UP ishte ne qender te konfliktit politik dhe krenaria e Kosovareve; ishte nje nga vendet me te politizuara ne te gjithe Kosoven; vemendja e ketij universiteti tani duhet te zhvendoset drejt Europes permes punes brenda kuardit te Bolonjes. Hapart e para jane: (1) perfshirja e vitit me strukture 3-5-8 (grada e pare shkencore, master, doktore); (2) aplikimi i sigurise cilesore; (3) adoptimi i sistemit te transfertit Kredit European; (4) zhvillimi i nje autonomie te veretete akademike, ndaj cdo Qeverie te ardhme’33.*
- *Duhet krijuar nje balance e veshtire midis kufizimeve te rrepta per vendet ne universitete(vetem 4.545 studente kete vit), dhe kapacitetit te sistemit te arsimit te larte per te perballuar me shume studente, si dhe kapaciteti i tregut te punes per te thithur me shume studente. Eshte e qarte qe shume te rinje deshirojne te vazhdojne arsimin e larte.Prandaj eshte e mundur te shtohen numrat e vendeve te punes ne disa disiplina ku ka mungese personah te kualifikuar. Duhet shtuar gjithashtu dhe vende part time , vecnerisht per te rriturit qe nuk kane mundesi te rregjistrohen ne universitet.*
- *Jane ne diskutim standartet akademike dhe pagesat. Gjate sisitemit ne “hije” u bene perpjekje per ti mbajtur studentet ne kete sisitem dhe kerkesat e pranimit si dhe kerkesat akademike nuk ishin te larta. Standartet akademike nuk duhet te ngrihen aq shume sa te arrijne nivelet Eurpiane; por rreziku i dekurajimit te studenteve ose i*

humbjes se tyre mund te jete i mundshem. Duhet ndjekur standarte cilesore per tu krahasuar me universitetet e tjera. Tani pageast jane te ulta por ka debate lidhur me (a) per ti hequr fare ato, per studentet e shkelqyer ose per ata qe nuk kane mundesi, ose (b) te ngrihen pagat vecanerisht per fakultete qe preferohen me shume, ku vendet jane te pakta.

- *Nje problem po aq i veshtire i “integritet etnik dhe linguistik”, duhet zgjidhur. Nuk ekzistojne shifra te sakta lidhur me studentet serbe dhe stafin universitare qe kane mbetur ne Kosove, por ka te dhena se ekziston nje diskriminim ndaj serbeve per tu pranuar ne universitet dhe per tu punesuar. Mesimdhenia tashme behet vetem ne nje*

32. Udhezimet mbi pranimin interim te Studenteve te rregullt, per semestrin e Dimrit te Viti 2000-2001, mbi ceshtjete Universitetit Lidhur me Zhvillimin e Stafit.

- gjuhe, vetem ne shqip, pervec disa fakulteteve qe ndodhen ne veri te Mitrovices, dhe disa iniciativave te vogla qe kane lindur ne vende te tjera te cilat lejojne qe disa studente serbe te studiojne ne gjuhen serbe.
- *Disa fakultete jane demtuar rende, vecanerisht Fakulteti i nxhinjerise ku dhe pajisjet e vjetra ruse jane shkaterruar dhe demtuar dhe nuk riparohen me. Meqe punesimi ne profilin inxhinjerik eshte shume i kufizuar studentet nuk jane shume te motivuar. Fakultetet e tjera per shembull, drejtesia kane rene shume gjate vitetve qe nuk lejoheshin gjykates dhe avokate shqiptare te aplikojne profesionin e tyre, dhe perpjekja per fakultetin juridik ne “hije” deshtoi.*
- *Vitet e gjata te sistemit ne hije kane krijuar nje kulture mesimmedhenie jo sistematike. Frekuentimi gjate ketyre viteve ra ne 50%. Studentet vinin vetem per provime; zhvillimi i personelit arsimor mund te themi se nuk ekzistonte fare; mesuesit dhe studentet nuk jane mesuar per te frekuentuar bibliotekat, per te lexuar shtypin profesional, dhe nuk kane mundesi ti gjejne ato. Prandaj ndihet shume nevoja e metodave moderne te pedagogjise per mesuesit dhe shprehje studimi aktive per studentet.*
- *Kosova dhe Universiteti nuk kane te dhena per punen kerkimore shkencore. Ka perjashtime por eshte e qarte se materiali dhe baza e njohurive jane te pamjaftueshme per te bere pune kerkimore shkencore, qe te mund te konkuroje shkollat ne rang nderkombetare. Kerkohet nje bashkepunim i hapur brenda Akademise. Qendra Qendrore Laboratorike (CLU) dhe lidhjet nderkombetare me partneret Europiane do te krijojne nje baze per pune kerkimore shkencore me te shendoshe dhe me te mirenjohur.*

Rekomandime

Politika dhe Menaxhimi

Qellimi kryesor eshte kalimi i arsimit ne duart e nje qeverie rajonale krejtesisht autonome por pa shkaterruar ate qe eshte ndertuar tashme’ 35. Ne Mars te vitit 2001 u zhvillua nje workshop 6 ditor me perfaqesue nga te gjitha nivelet, ku u parashtrua struktura e re me pjesemarrje serbe dhe jo serbe.

- *Nevojiten programe trajnimi per te gjitha nivelet* me asistence teknike nderkombetare. Formuluesit e politikave ne plan ministerial duhet te studiojne sistemet arsimore jashte shtetit, te trajnohen jashte, te lidhen me akademite e tjera dhe hartues politikash, dhe ne pergjithesi te fitojne eksperience ne fushen e menaxhimit nderkombetare te universiteteve. Teknikat e menaxhimit te burimeve njerezore moderne duhet te jene pjese e programeve te trajnimit, ku te perfshihen metoda konstruktive dhe moderne per vleresimin e stafit, ne menyre qe te krijohet nje praktike e mire dhe te arrihet zhvillimi i personelit. Koncepti i Agjesisse Drejtuese, duhet te shtrihet dhe te grupet e reja te donatoreve, sepse buxheti i Kosoves nuk eshte ne gjendje te financoje reforma me permasa te medha.

33. Michael Daxner, Deklarata e Politikes Arsimore, 2001, f.10.

- *Programi i rindertuar eshte interesant*, por godinat jane vetem fillimi. Shkollat duhet te zhvillohen me pjesemarrjen e komunitetit, dhe te behen nje vend ku secili qe deshiron te mesoje- prinderit, femijet, njerzit e papune, dhe vecanerisht mesuesit. Sindikatat e mmesuesve te cilat kishin shume influence ne sistemin paralel duhet te perfshihen me shume ne vendimarrje ne fushen arsimore. Nese nuk perfshihen rezultati do te jete puna opozitare e sindikatave dhe jo bashkpunimi. Situata disi e ndere per momentin.

Rekomandime: Kurrikulum, Standarte dhe Vleresim

Te vendoset nje sistem i zhvillimit te curriculimit qe te integroje kurrikulumin, vleresimin e studentit dhe provimin, metodat e trajnimit dhe te mesimdhenies, librat dhe materialet qe kane per synim te perfshijne strategji te reja te mesimit dhe te mesim dhenies ne klase.

Te bazohet ky sistem ne disa parime te qarta duke perfshire :

- *Krijimin e nje procesi ndryshimi*. Ka shume rendesi te krijohet nje autoresi ne institucionet lokale, vecanerisht te mesuesit dhe jo thjeshte te perfshihen ata ne planifikimin dhe zbatimin e curricules se re. Shume specialiste lokale ndejne zhgenjim se aftesite dhe eksperienca e tyre nuk perdoren aq sa duhet. Duhet krijuar nje mekanizem i konsultimit publik qe te rritet pergjegjesia publike ne berrjen e reformave.
- *Fleksibiliteti, zhvillimi i curricules* duhet pare si nje proces ciklik jo linear. Grupi baze duhet te mendoje dhe te analizoje punen ne koordinim me specialistet lokale dhe ne menyre te rregullt te studioje dhe te ripunoje planin e zhvillimit dhe curriculen e re.
- *Studimi i modelit*. Gjate procesit te zhvillimit te curricules pjesemarrjes do te fitojne aftesi per te hartuar dhe zhvilluar dhe projekte te tjera , pershembull, ne fushen e reformes per trajnimin e mesuesve si dhe zhvillimin e materialeve mesimore.
- *Te krijohet nje ekuiliber* per sa i perket shpejtesise se reformes duke shqyrtuar me kujdes influencen e saj ne tere sistemin arsimor. Tashme ka ardhur koha te mosshkruhen me raporte por te filloje puna e ketij sistemi ne praktike. Eshte e lehte per disa pjese te ketij sistemi (pergatitja e mesuesve e metodave e materialeve e metodave te vleresimit) qe te ecin krahas zhvillimit te curriculimit. Agjensia Drejtuese mund te zhvilloje module te vogla per tema qe tregojne aspekte te rendesishme te rinovimit te curriculimit; kjo do t'u jepte mmesuesve disa materiale per t'u perdorur ne klase. Mesuesit do te kuptonin me mire se cfare nenkuptohet “ me standarte te reja europiane”per shembull, disa materiale te reja leximi, si ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhe te huaj; matematika e aplikuar; shkenca e perditeshme jetesore. Nese keto fusha do te jene ne qender te vemendjes per Bordin e Vlersimit dhe te Standarteve, atehere keto perpjekje do te mirepriteshin. Perfshirja aktive e mesuesve

ne reformen e curriculimit do te sherbente jo vetem si ngritje e tyre profesionale, por edhe si nje shperndarje direkt e curricules se re per punen praktike brenda ne klase.

- Permirosimi i procedurave me te dhena per monitorimin dhe krahasimin e rezultateve ne arsim. Kualifikimi lidhur me mendesite e punesimit eshte problem madhor per ndertimin e Kosoves se ardhme.

34. Lynn Davies, Arsimi ne Kosove, Raport drejtuar Keshillit Britanik”, e pabotuar, Gusht 1999, f.28.
35. Michael Daxner, Deklarata e Politikes Arsimore, 2001, 7 Janar 2001, f.3, Pristine.

- *Standartet e Propozuara dhe Bordi I Vleresimit (SAB) mund ti kaperxjne pengesat etnike, duke dhene informacion te dobishem per te gjithë pjesemarrësit ne kete reforme. Eshte shume e rendesishme qe metodat e vleresimit te mos perdoren thjeshte per matjen e arrijteve, por te funksionojne si nje tranzicion drejt metodave me moderne.*
- *Krijimi i mbeshtetjes profesionale per vleresimin ne klase. Aktivitetet e SAB duhet te japin rezultate qe te mbeshtesin mesuesit ne punen e tyre vleresuese ne klase, dhe ti ndihmojne ata per te zbuluar sa arrijne studentet te pervesojne materialin mesimor. Kjo behet duke krijuar nje procedure per metoda vleresimi ne plan kombetare, dhe krijim e testeve per te gjithë mesuesit.*
- *Perputhja e matures me provimet e pranimit ne universitet. I duhet dhene fund provimit te sistemit te “dyfishte”. Nese do te mbeten provimet e pranimit ne universitet, duhen bere perpjekje qe te pranohen te njejtat provime dhe per fakultete te, ndryshme ne menyre qe te rriten mundesite e rregjistrimit te studenteve. Gjithashtu duhe bere perpjekje qe vleresimi te behet transparent per studentet.*

Rekomandime: Mesuesit

- *Te trajnohen te gjithë mesuesit per te kaluar ne sistemin e ri. Megjithë respektin per arrijtet gjate sistemit te kaluar paralel, eksperiencia e fituar atje nuk eshte nje kriter per te percaktuar nje edukator te mire’³⁶. Zhvillimi i sistemit te trajnimit qe mbeshtet zhvillimin e curriculimit me baze shkollen, si nje trajnim i “centralizuar”, eshte shume me i veshtire per tu organizuar dhe menaxhuar. Ky model i trajnimit “brenda ne shtepia” duhet te perfshije mesues dhe administratore nga e njejtat shkolle, ne menyre qe ndryshimet te kene nje influence te dallueshme ne praktiken brenda klases.*
- *Te qartesohen prioritete per mesuesit ne menyre qe te evitohet copezimi dhe mbingarkesa ne reformen arsimore ne Kosove. Duhen caktuar prioritete te qarta dhe te pranuar nga te gjithë per te percaktuar se cfare duhet reformuar, dhe si duhet bere reforma. Prioriteti I pare duhet te jete heqja nga curriculumi I permbajtjes se panevojshme dhe te pareshtatshme ne mesimdhënie, per ti lene vendit fromimit te shprehive dhe qendrimeve te reja. Nje prioritet tjeter duhet te jete perqendrimi i vemendjes tek ata femije qe kane nevoja te vecanta, kur e ndjekin rregullisht shkollen ose per ata femije qe nuk e ferkuentojne shkollen, sepse kane nevoja te vecanta per te mesuar.*

- *Te krijohet nje program trajnimi per mesues gjate shkolles ne Universitetin e Prishtines. Mesuesit pergatiten ne institute te ndryshme ne Kosove (shih Tab.2 siper). Problemi eshte se nuk ka nje filozofi te qarte ose baze teorike per pergatitjen e mesuesve. Ne shume vende europiane dhe ne disa venda te rajonit te Europes Lindore, trajnimi I mesuesve eshte pergjegjesia e univeristeteve, dhe universiteti ka nje Fakultet per Arsimin ose dicka te ngjashme. Fakulteti pergjigjet per curriculumin e trajnimit ne menyre qe ai te kete nje permbajtje te shendoshe pedagogjike per te zhvilluar aftesi mesimdhenie, dhe per te kuptuar sa me mire femijet.*
- *Per kete qellim gjithë trajnimi per mesues ne shkolle duhet te futet nen ombrellen e Universitetit te Prishtines. Ne universitet duhet te kete nje fakultet te ri , per pergatitjen e mesuesve, per shembull, Fakulteti i Arsimit. Ky fakultet duhet te pergatise mesues per shkollen*

36. Lynn Davies, Arsimi ne Kosove, Raport drejtuar Keshillit Britanik”, e pabotuar, Gusht 1999, f.28.
37. Michael Daxner, Deklarata e Politikes Arsimore, 2001, 7 Janar 2001, f.3, Prishtine.

parashkollore, fillore, te mesme te pergjithshme, dhe per arsimin special. Megjithate, pergatitja e mesuesve eshte aq e rendesishme sa qe nuk mund te jete vetem pergjegjesia e fakultetit te Arsimit. Te gjitha fakultetet duhen te jene te ndergjeegjshem per kete pergjegjesi dhe te kontribuojne ne pergatitjen e mesuesve.

- *Te vleresohen nevojat per trajnimin e mesuesve. Duhet te behet nje analize serioze sa me shpejt te jete e mundur. Nuk ka struktura institucionale ne nivel qendror, rajonal ose bashkiak, qe te sigurojne cilesine e trajnimit te mesuesve. Kjo ka shume rendesi sespe ne fillim te vitit 2001 doli ne qarkullim nje curriculum kombetare si dhe tekste te reja dhe procedura te reja vleresimi. Duhet krijuar nje strukture institucionale ose nje takse force, te pakten per 2 ose 3 vitet e rdheshme per te siguaruar nje politike racionale dhe koherente per trajnimin e mesuesve ne Kosove.*
- *Te vendosen standarte dhe mekanizma vleresimi per mesimdhenie te mire. Duhet rishikuar konceptet se cfare quhet shkolle e mire, ne pergjithesi, dhe mesimdhenie e shkelqyer, ne vecanti. Keto standarte duhen vendosur per te gjithë mesuesit , se pari qe te kuptojne se cfare do te thote mesim dhe mesimdhenie e “mire”. Keto standarte duhet te jene te qarta, ne menyre qe mesuesit te krahasojne pune e tyre me ate qe do te ishte ideale, se dyti, duhet te krijohet nje mekanizem per monitorimin e cilesise se mesimdhenies, dhe per vleresimin e punes se mesuesit. Sistemet tradicionale te inspektimit ne shkolla, dhe strukturat e mbikqyrjes te mesuesve ndoshta nuk jane zgjidhja me e mire.*

Rekomandime: Arsimi Parashkollor

- *Koordinimi i programeve mbi shendetin dhe mireqenien per grup moshen 0-3 vjec. Permiresimi per kujdesin shendetesor te nenes dhe femijes eshte nje domosdoshmeri (programet e reja jane te perqendruara ne kontributin qe jep komuniteti). Rekomandohen fushata ne fushen arsimore, per ushqimin sa me te mire te femijve, programet e OJQ-ve si pershembull, Aksion kunder Urise, mund te jene ne baze te ketyre fushatave shendetsore per te krijuar praktikat sa me te mira, ne fushen e zhvillimit te femijes, ne sherbime klinike shendetsore. Kopshtet dhe cerdhet duhen te krijojne nje rrjet informacioni per prinderit dhe per ata qe kujdesen per shendetin e femijve. Eshte shume e rendesishme te koordinohen sherbimet e ministrive dhe*

agjensive per te krijuar sa me shume burime dhe barazi ne shperndarje te informacionit dhe te mjeteve. Mekanizmi koordinues brenda agjensive i rekomanduar ne DESK duhet te koordinohet me punen e qeverise.

- *Te permiresohet pergatitja e mesuesve.* Njohja e zhvillimit te femijes duhet te jete pjese e te gjithe programeve te pergatitjes se mesuesve. Pavec kesaj, ceshtje prioritare duhet te jete trajnimi profesional i personelit qe merret me moshen parashkollore.
- *Mbeshtetje per personelin parashkollor.* Duke patur parasysh nivelin e ulet ekonomik dhe kapacitetin e ulet teknik te sistemit te tanishem ,eshte e pamundur qe te perfshihen ketu te gjithe femijet nga mosha 5 vjec e larte. Femijet e familjeve me te ardhura te ulta, duhet te mbeshteten nga qeveria per tu futur ne ciklin parashkollor qe i perket sektorit privat, gjithsshtu duhet te kete inkurajim te vazhdueshem per ata qe deshirojne te krijojne cerdhe dhe kopshte private, dhe krijohet kaudri ligjor per te percaktuar standartet e nevojshme.
- *Te permiresohen mundesite e arsimit per vajzat.* Ndergjegjesimi per nevojen e arsimit te vajzave duhet te filloje ne nivel parashkollor, dhe prinderit duhet te inkurajohen per te regjistruar vajzat ne programet e arsimit parashkollor.
- *Te vazhdohen dhe te zhvillohen programet pilot.* Administrata duhet te punoje me OJQ-te per tu siguruar qe permiresimet ne pedagogji te ecin krahas programeve te trajnimit te mesuesve, dhe jo te rresht kjo pune sapo te largohen OJQ-te.
- *Te hartohet nje metode koherente per lidhjen e sistemit parashkollor me sistemin fillor.* Nje tranzicion i lehte nga sistemi parashkollor tek sistemi fillor kerkon mesues te kualifikuar, kerkon bashkepunim dhe zhvillim te programeve te ketij tranzicioni, vecanerisht tani qe femijet 6-vjecare jane perfshire ne ciklin fillor.

Rekomandime; Arsimi profesional

- *Te shpejtohet trajnimi i mesuesve profesional dhe punesimi i tyre.* Ne personelin e tanishem mesimor duhen identifikuar ata mesues te talentuar ne menyre qe te formehen nje grup baze per ta arritur “ndryshimin” e cila do te ndergjegjesonte zhvillimin e personelit ne shkollë dhe ne nivel bashkiak. Ky grup baze duhet te perfshije instruktore qe kane aftesi ne praktike dhe qe jane “mjeshtra”. Keta mesues profesional qe do te shtojne numrin e personelit mesimor ne baze te kesaj fushate te gjere, duhen te kene parasysh kandidatet te cilet (a) kane humbur pozitata e tyre ne industri dhe duan te bejne profesionin e mesuesit, ose (b) qe kane nje eksperience pune ne ndermarrje ose kane eksperience profesionale te marre jashte shtetit si refugjate. Keta kandidatet mund te marrin pjese ne nje trajnim intesiv te planifikuar per mesues te pakualifikuar, pershembull, ata qe mbeshteten nga Fondet Kanadeze, ose nga propozime te tjera te Agjensise Drejtuese.
- *Te zgjerohet perspektiva.* Trajnimi intesiv i ketij grupi baze duhet te perfshije trajnim per praktike te “mire” dhe ne organizatat e zhvillimit te curriculumit ne BE dhe pertej, per shembull, ne metoda te reja, ne menaxhimin e hapur te klases ne aftesite komunikuese, ne shprehitee punes ne fushen industriale, dhe ne formim partneritetit. Vemendje e vecante i duhet dhene krijimit te nje balance midis trajnimit me baze punen, dhe trajnimit te pergjithshem pedagogjik per mesuese te shkolles profesionale.

- *Orientimi i trajnimit drejt praktikës.* Trajnimi i mesuesve të arsimit profesional duhet të lidhet ngushtë me punën. Vështiresi e madhe në Kosovë krijohet nga fakti se ndermarjet nuk janë në gjendje të mbështesin trajnimin e mesuesve. Projektet pilot mund të krijonin mundësi të reja që shkollat dhe ndermarjet të mesonin se bashku dhe rezultatet të shpërndahen në shkolla të tjera dhe në fusha të ndryshme ekonomike.
- *Te përdoret gjerësisht ekspertiza e re në Kosovë.* Në 8 vitet e fundit është bërë punë e madhe për trajnimin e mesuesve dhe reformën e curriculës nga BE dhe Programi PHARE. Politika dhe eksperiencat e vendeve fqinje (për Shqipëri, Slloveni e cila ka të njëjtat lidhje historike me ish-Jugosllavinë, duke përfshirë dhe kuadrin institucional për arsimin dhe trajnimin) mund të përdoren në këto raste. Në Slloveni reforma për trajnimin e mesuesve profesional dhe modernizimi i curriculës u bë në shkollë me përfshirjen e partnerëve socialë dhe kjo mund të shërbejë si model dhe për reformat në Kosovë.
- *Përfshirja e partnerëve socialë.* Agjencia Drejtuese duhet të sigurohet që partnerët socialë të integrohen në strategjitë e trajnimit të mesuesve dhe të reformës së curriculës. Zhvillimi i personelit të shkollës (drejtore, mesues, personeli ndihmës) me lidhje shkollë-ndermarje duhet të përfshijë punëdhënësit dhe grupe të tjera sociale.
- *Te krijohen shërbime drejtimi dhe keshillimi në çdo shkollë profesionale.* Mund të formohet një rrjet mesuesish dhe të hartohet një program trajnimi. Në këto trajnime mund të marrin pjesë persona nga zyrat lokale të punësimit dhe partnerët socialë dhe zhvillimi i një shërbimi me profesional keshillues mund të bëhet pjesë e strategjisë së reformës në arsimin profesional dhe në fushën e punësimit. Ka shumë rëndësi të ndërtohet një strategji për mesimin profesional në të gjitha shkollat, në mënyrë që të rinjtë të përgatiten për punë.

Rekomandime: Arsimi I Lartë

- *Te ruhet influenca e faktorit ndërkombëtar që krijojnë ndryshim në curriculë, pedagogji, cilësi, vlerësim dhe ngritje të vazhdueshme profesionale.*
- *Te njihen studimet e mëparshme që janë bërë nga studentët të cilët rregjistrohen në Uprishtinë, Po kështu gradat shkencore të marra nga UP të jenë të vlefshme dhe për Universitetet e tjera Evropiane. Kjo nënkupton transparencë të plotë në curriculum, në procedurat e provimit, dhe në procedurat e marrjes së gradave shkencore, si edhe në përdorimin e sistemit të akreditimit.*
- *Te zhvillohet dhe të zbatohet kuadri I ri ligjor për arsimin e lartë në Kosovë dhe të bazohen këto orientime të reja sipas standarteve evropiane dhe kuadrit të Bolonjes për të siguruar njohjen e kualifikimeve dhe mundësitë e punësimit të studentëve.*
- *Te forcohet bashkëpunimi rajonal (p.sh. me Tetovën, Maqedoninë, dhe me Arsimin e Lartë në Serbi, Mal të Zi dhe Shqipëri) dhe të zgjidhet çështja e “universitetit në mërgim” në Mitrovicë.*
- *Te përqendrohet vëmendja në pajisjen e Laboratorit Qendror dhe Bibliotekës për të mbështetur procesin e mesimdhënies, të mesimit dhe të punës kërkimore shkencore.*

- *Te ushtrohet me pak kontroll dhe te sigurohet me shume drejtim.* Qellimi kryesor duhet te jete te largohemi nga “ tipi i direktivave” drejt nje modeli i cili ofron keshillim me te mire, mbikqyrje dhe drejtim permes bashkeveprimit dhe mbeshtetjes.
- *Te modernizohen metodat e mesimdhenies dhe mesimit.* Kalimi nga mesimi me ne qender mesuesin drejt mesimit me ne qender nxenesin, nenkupton zevendesimin e stilit autoritar me stilin e mesimit bashkeveprues, e cila eshte tendenca moderne e mesimdhenies. Zbatimi i elementeve jashte universitetit si media, persona politike dhe te tjer, dhe modernizimi i pergjithshem i didaktikes, jane ceshtje kryesore ne fazen e planifikimit.
- *Te luftohet korrupsioni.* Si ne shume sfera te shoqerise kosovare korrupsioni eshte i pranishem dhe brenda sistemit te larte arsimor. Kjo krijon nje situatë te vecante ku shume aleate te njohur te reformes behen shkak per pakenaqesi publike. Blerja e vendit te punes, tregtia me pyetjet dhe pergjigjet e provimit, keqperdorimi i fondeve te donatoreve, jane disa nga problemet ne kete fushe, Arsimi ka qene gjithnje terreni me i politizuar per forcat e ndryshme politike. Ne Universitet akoma ndihet kjo fryme, pamvaresisht nga perpjekjet per te zbatuar statutin demokratik dhe strukturat transparente. Te gjitha partite bejne fushate per te krijuar nje sistem te depolitizuar dhe te pakorruptuar, por ata duhet te perpiqen akoma me shume per te arritur qellimin e tyre.
- *Te hartohen masa qe te inkurajojne akademiket e rinj per tu kthyer ne Kosove.*

